# RAPORT

# I VLERËSIMIT TË JASHTËM

## Për Programin e studimit Master Profesional "Studime mbi Sigurine"

Eksperti i vlerësimit të jashtëm: Prof.As. Dr. Luan Hajdaraga

Maj 2016

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Për Programin e studimit MP Studime mbi Sigurine**

| | Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit: | |
|---|---|---|
| 1 | IAL Aplikues: | Universiteti Privat Albanian University |
| 2 | Fakulteti që e ofron | Fakultetit të Shkencave të Shoqërore |
| 3 | Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit | Urdhër Nr. 597, datë 28.05.2009 (*) (**) |
| 4 | Titulli i programit të studimit: | MP Studime mbi Sigurinë |
| 5 | Cikli i studimit: | Cikli I dytë |
| 6 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 1.5 vite/3 semestra |
| 7 | Kreditet në total (ECTS): | 90 ECTS |
| 8 | Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/): | Kohë e plotë |
| 9 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 10 | Programi ofrohet nga institucioni | PO |
| 11 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera | - |
| 12 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 13 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 14 | Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve | 7 |
| 15 | Aktivizimi i programit të studimit | 2009-2010 (***)<br>2010-2011 (****) |
| 16 | Brezi i parë i diplomimit të studentëve | 2010-2011 (*****)<br>2011-2012 (******) |
| 17 | Numri i studentëve | 15 |

(*) Licensuar si MND në Studime mbi Sigurinë

(**) Në RVB dhe gjatë vizitës në Institucion, GVJ iu vendos në dispozicion shkresa Nr. 10/2 Prot, datë 03.02.2011, AU i drejtohet Drejtorisë së Zhvillimit të Arsimit Privat, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës "Përshtatja e programeve të studimit nga Master i Nivelit të parë në Master Profesional dhe Master i nivelit të dytë në Master Profesional sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007, I ndryshuar me dt 22.07.2010, neni 26 dhe neni nr. 99/2

(***) Në vitin 2009-2010 është aktivizuar si MND në Studime mbi Sigurinë

(****) Në vitin 2010 – 2011 është aktivizuar si MP në Studime mbi Sigurinë

(*****) Në vitin akademik 2010-2011 ka përfunduar brezi i parë i studentëve si MND në Studime mbi Sigurinë

(******) Në vitin akademik 2011-2012 ka përfunduar brezi I parë I studentëve si MP në Studime mbi Sigurinë

**HYRJE**

Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative në Institucionin e Arsimit të Lartë "Albanian University" është pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Shoqërore.

Ky departament ofron programe të akredituara nga MASH në perputhje me "Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqiperisë" nr. 9741, dt 21.05 2007 i ndryshuar me Ligjin nr 10307 dt 22.07.2010 "Për disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin 9741 dt 21.05 2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë".

Departamenti i Shkencave Politiko – Administrative ofron:

nje program "Bachelor", 5 Programe "Master" (pjesë e ciklit të dyte të studimeve), dhe 2 programe studimi të ciklit të tretë, "Doktoraturë" si më poshtë:

- Bachelor "Shkenca Politiko - administrative
- Master Shkencor "Marredhenie Nderkombetare".
- Master Shkencor "Administrim Publik"
- Master Shkencor "Marredhenie Nderkombetare dhe Diplomaci"
- Master Profesional "Qeverisje dhe Administrim Publik
- Master Profesional "Studime mbi Sigurine"
- Phd "Marredhenie Nderkombetare"
- Phd "Shkenca Administrative"

Programi i studimit Master Profesional ne" Studime mbi Sigurine" eshte ofruar si program studimi Master i Nivelit te Dyte ne vitin akademik 2009-2010.

Me ndryshimin e ligjit per Arsimin e larte ne RSH. nr 9741 dt 21.05.2007 (me perditesimin e ligjit me nr. 10307, te dates 22.07.2010 dhe ligjit 10493 te dates 15.12.2011) me vendim te Senatit te "Albanian University" me shkrese nr 10/2 me dt 03.02 2011 Programi i Studimi MND "Studime mbi Sigurine" riorganizohet ne Master Profesional ne "Studime mbi Sigurine ".

Nga dokumentacioni shkresor ne departament, rezulton se Masteri i nivelit te dyte ka funksionuar per nje periudhe 1 vjecare, me 60 kredite per vit akademik me dy semestra.

Masteri Profesional "Studime mbi Sigurine" eshte konceptuar si Master i ri me 90 kredite dhe kohezgjatje 1.5 vite akademike

Por nga analiza e dokumentacionit shkresor del se nuk ka vazhdimesi organike ndermjet ketyre dy masterave, per faktin se nuk rezulton qe diploma e marre ne perfundim te Masterit te Nivelit te dyte te jete e akredituar nga Ministria e Arsimit. Ne sekretarine mesimore te institucionit egziston nje korespondence shkresore per kete problem por qe nuk ka cuar ne njohjen e diplomave te Masterit te Nivelit te dyte. Per kete e shohim te arsyshme te theksojme se kjo ceshtje duhet te mare zgjidhjen e duhur.

Masteri profesional "Studime mbi Sigurine" eshte ndertuar mbi bazat, kriteret dhe metodologjine qe duhet te plotesoje nje program Masteri Profesional, mbeshtetur ne Ligjin per Arsimin e Larte ne RSH nr 9741 dt 22.05.2007 i ndryshuar, ne aktet nenligjore ne reference te tij si dhe ne Statutin dhe Rregulloren e funksionimit te IAL-Albanian University.

Programi Master Profesional ne "Studime mbi Sigurine" funksionoi vetem per nje cikel te plote akademik ne periudhen 2011-2012. Per mungese kontigjenti studentesh dhe ofertes nga disa universitete publike dhe jopublike, nuk u arrit qe ky program studimi te kete vazhdimesi.

Programi Master Profesional ne "Studime mbi Sigurine" synon ti pajise studentet me njohuri te thelluara per sigurine, politikat dhe instrumentat e sigurise kombetare, per organizatat nderkombetare te sigurise rajonale dhe globale. Per studentet, programi parashikon nje njohje me te gjere te teorive gjeopolitike, te teorive klasike te sigurise, si

atyre konvencionale por dhe bashkekohore. Ne kete program studentet marrin njohuri te plota mbi Strategjine e Sigurise Kombetare, per mjedisin e ri te sigurise ne rrafshin rajonal e global, mbi luften kunder terrorizmit dhe krimit te organizuar, mbi konceptet themelore te komunikimit publik, politik, e psikologjik ne situate krizash dhe postkrizash.
Studentet nepermjet ketij progami marrin njohuri te thelluara per konceptet dhe praktikat themelore te sherbimeve intiligjente mbi sigurine kombetare dhe globale ne perballje me sfidat e rreziqet si terrorizmi, krimi i organizuar, korupsioni.
Vemendje e posacme ne programin e Masteriatit profesional "Studime mbi Sigurine" i kushtohet aftesimit teoriko praktik te studenteve nepermjet puneve te pavarura ne lendet e programit si dhe ne punimet seminarike, intershipit, punimit te diplomes etj.

## GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

- ☑ Përbërja e GVJ:

1. Prof.As Dr Luan Hajdaraga

*Me shkresë Nr. 38/41 Prot, datë 05.05.2016 nga APAAL në Instiucion dërgohet Draft Raporti I Vlerësimit të Jashtëm. Më shkresë Nr. 53/39 Prot, 10.05.2016 nga Institucioni vjen shkresa "Kthim përgjigje për Draft – Raportet e Vlerësimit të Jashtëm".*
*Pas njohjes me Komentet nga ky Institucion mbi Draft RVJ, Eksperti e Vlerësimit të Jashtëm, nuk merr në konsideratë asnjë nga pikat e sugjerimeve të Institucionit duke i konsideruar informacione shtesë të cilat nuk sjellin të nevojshëm ndryshimin e Raportit të Vlerësimit.*

## 2. Misioni/Objektivat e programit të studimit

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference**: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

**Programi i studimit Master Profesional ne "Studime mbi Sigurine" eshte pjese e programeve studimore te Fakultetit te Shkencave Shoqerore (departamentit te shkencave politiko-**administrative) te IAL-Albanian University. Ky program studimor perkon me qellimet e objektivat, strategjite afatmesme te ketij institucioni per te pergatituer specialiste me kualifikim te larte per nevojat e sektoreve te ndryshem te jetes se vendit, te afte per te zgjidhur detyra nga me komplekse qe shtron zhvillimi i vendit , ne rastin konkret problematikat qe paraqet fusha e sigurise kombetare.

Programi studimor iu ofrohet studenteve si nje mundesi optimale per tu thelluar ne dijet dhe praktikat bashkekohere te sigurise kombetare dhe nderkombetare, per te njohur konceptet dhe metodat per trajtimin e dukurive te sotme te krimit te organizuar, terrorizmit, trafiqeve.Programi ka harmonizuar lende te profilit ,me ato te specialiteve te ngushta, lendeve teorike me punen praktike te pavarur, synon te nxise mendimin krijues dhe alternativ, te stimuloje kerkimin shkencor per formulimin e hipotezave dhe gjetjen e zgjidhjeve objektive.Programi studimor eshte i inkuadruar ne Strategjine e zhvillimit institucional te ketij institucioni dhe disenjimi i tij eshte realizuar ne perputhje me kerkesat e zhvillimit ekonomiko social te vendit, me nevojat e tregut te punes per specialiste me kualifikimte larte ne sektoret e sigurise kombetare.

### Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve[1] |
|---|---|
| **Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.** | |
| **Kriteri 3** Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit; | Kriteri 3. Programi i studimit Master Profesional ne" Studime mbi Sigurine" eshte hartuar dhe miratuar ne perputhje me obje ektivat dhe strategjine e zhvillimit te Universitetit" AU" , dhe te fakultetit te Shkencave Shoqerore te tij. |
| **Kriteri 4** Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës; | Kriteri 4. Programet e studimit te Masterit Profesional "Studime mbi Sigurine" , jane hartuar duke marre parasysh nevojat e tregut te punes per specialiste te afte ne sektoret rendit publik, ,ushtrise dhe sherbimeve intiligjente , te pajisur me informacion koncepte dhe praktika te reja qe pasqyrojne nivel bashkekohor, |
| **Kriteri 5** Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit; | Kriteri 5. Programi i mesiperm eshte hartuar ne perputhje me kerkesat e zhvillimit eko nomiko social te vendit , per specialiste te fushave te sigurise , me nivel te larte pergatitjeje teorike praktike ,te afte per te perballuar problematikat e reja me te cilat perballen sektoret e sigurise ne vendin tone. |
| **Kriteri 6** Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit. | Kriteri 6. Programet e Studimit te Fakultetit te Shkencave Shoqerore dhe ato te Masterit Profesional "Studime mbi sigurine" ,bazohen dhe promovojne vlerat e shendosha te tradites arsimore e kulturore te vendit dhe harmonizojne nivelin bashkekohor te zhvillimeve te displinave ne lemin e sigurise me pervojen e institiuciove tona te arsimit te larte si dhe me praktiken e perftuar nga sektoret fushes se sigurise ne vendin tone. |
| **Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit; | Kriteri 1.Programet e studimit qe zbatohen nga "Albanian University" jane te inkuadruara ne Strategjine e Zhvillimit institucional te ketij Institucioni te miratuar nga organet vendimarrese te tij, konkretisht me "Strategjine e zhvillimit institucional per periudhen 2013-2017". |
| **Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.** | |
| **Kriteri 1** Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi; | Kriteri 1. Programi i Studimit Master Profesional "Studime mbi Sigurine" eshte hartuar ne perputhje me kriteret e percaktuara nga aktet ligjore e nenligjore ne fuqi , bazuar ne Ligjin per Arsimin e Larte ne Republikem e Shqiperise |
| **Kriteri 2** Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit. | Kriteri 2. Emertimi i ketij programi master profesional i ploteson ne menyre optimale kushtet dhe kriteret e duhura dhe eshte ne perputhje me nivelin e kualifikimit te percaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualfikimit. |

[1] GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmbledhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.

| **Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.** | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve; | Kriteri1. Institucioni ka hartuar nje plan strategjik te detajuar ku jane parashikuar objektivat afatmesme te permiresimit cilesor te programeve te studimit ,te orientuara ndaj kerkesave te tregut te punes dhe rritjes se niveli cilesor te mesimdhenies e te formimit te studenteve.<br>Ne kete kuader eshte parashikuar nje ngritje cilesore e nivelit te programeve ,kurikulave , teknologjise se mesimdhenies dhe mesimnxenies. |
| **Kriteri 2** Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit. | Kriteri 2. Ky institucion disponon nje plan strategjik per zhvillimin institucional te titulluar. 'Strategjia per zhvillimin institucional ne Albanian University 2013-2017" ku jane percaktuar objektivat per nje permiresim te vazhdueshem te programeve studimore, te metodave dhe proceseve te mesimdhenies, aplikimit te teknikave dhe teknologjive bashkekohore te cilat sigurojne nje pjesematrje interaktive te studenteve ne leksione, seminare, veprimtari praktike, laboratore, praktika studimore etj. |
| **Konkluzionet e vlerësimit:**<br>Programi Master profesional ne" Studime mbi Sigurine" eshte miratuar me vendimin nr.193 dt 24 03 2011 sipas pikes c te Rregullores per" Riorganizimin dhe funksionimion e Fakultetit te Shkencave Shoqerore dhe riorganizimin e programeve te studimit Master te Niveli te dyte ne Master Profesional te Senatit Akademik te etij Universiteti.<br>Programi Master Profesional "Studime mbi Sigurine" ofron per studentet mundesi te medha per nje formim adekuat ne profilin profesional te specialistit ne fushen e sigurise ,te afte per tu perballuar me sfidat e reja te sigurise ne plan kombetar dhe rajonal,sfida te cilat kerkojne nje pergatitje multidisplimnore, nga fushat marredhenieve nderkombetare, rendit intiligjences , te luftes kunder terrorizmit, krimit te organizuar etj.<br><br>Programi Master profesional ne "Studime mbi Sigurine" eshte hartuar mbi bazen e kerkesave per nje pergatitje cilesore te profesionisteve te fushes, duke u ofruar atyre nje problematike bashkohore te ceshtjeve te sigurise ne plan kombetar , rajonal dhe global ,mbeshtetur ne nevojat edhe kerkesat e sektoreve perkates per specialiste me dije e aftesi praktike bashkekohore. | |

## 3. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference**: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

**Njesia studimore e programit master profesional ne Studime mbi Sigurine eshte pjese e struktures se deparatamentit te shkencave politiko administrative ne Fakultetin e Shkencave Shoqerore te ketij institucioni**. Kjo njesi ka qene e kompletuar me stafin e nevojshem, te rekrutuar sipas ligjeve ne fuqi dhe i ka permbushur detyrat funksionale sipas statutit dhe rregullores Ne njesine perkatese ka nje dokumeracion te rregullt per veprimtarine e saj gjate periudhes se funksionimit te programit master.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

☑ **Eksperti përshkruan gjëndjen e konstatuar në Institucion në Raport me të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta**

**tregues. Eksperti evidenton ndryshimet dhe shprehet nëse ka ndyshime dhe sa këto ndryshime ndikojnë në përmbushjen e standardeve që lidhen me këta tregues.**

Ne analize te gjendjes se konstatuar ne Njesine e programit Master profesional Studime mbi Sigurine dhe kontrollit te ushtruar ne kete dokumentacion, rezulton se nuk ka ndryshime me te dhenat e paraqitura ne Raportin e Vleresimit te Brendshem (RVB) .

Programi studimor Master Profesional "Studime mbi Sigurine" ka funksionuar vetem per nje cikel akademik. Si rezultat i ketij fakti nuk disponohet nje baze te dhenash te te bkrahasushme per te ndjekur ecurine e permbushjes se standarteve qe lidhen me keta tregues ne cikle te tjera.

☑ **Fakulteti, Organizimi hierarkik i Fakulteti**

**Fakulteti i Shkencave shoqerore perbehet nga:**

- Departamenti i shkencave juridike
- Departamenti i shkencave politiko administrative
- Departamenti i Psikologjise se Pergjithshme
- Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes

Programi Master Profesional "Studime mbi Sigurine" ben pjese ne Departamentin e Shkencave Politiko Administrative.

☑ **Organet e zgjedhura në të gjitha nivelet**

Rekrutimi stafit akademik per programin e studimit Master Profesional ne Studime per Sigurine eshte bere me konkurs sipas ligjit te Arsimit te larte ne fuqi, Statutit e Regulloores se institucionit dhe per secilin ka nje dosje te kompletuar ne Zyren e burimeve njerezore. Ne institucion zhvillohen sipas ligjit, konkurset per zgjedhjet ne postet drejtuese te Dekanit te fakultetit, Shefit te departamentit, Shefit te programit master profesional.

☑ **Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Per nevojat e grupit te vleresimit te jashtem ,per te patur nje baze me te plote te dhenash u dha ne dispozicion material plotesues per studentet qe frekuentuan programin masterin profesional Studime mbi Sigurine, dosjet ne sekretari mesimore punet e pavarura ne lendet e programit, punimet e diplomes etj

| **Standardi/Kriteret** | **Vlerësimi sipas standardeve** |
|---|---|
| **Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e t<br><br>**Kriteri 2** Institucioni ka së paku dy Fakultete;<br><br>**Kriteri 3** Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;<br><br>**Kriteri 4** Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar; | Kriteri 1. Struktura organizative e funksionale e "Albanian University" eshte strukturuar ne permbushje te objektivave dhe misionit te tij,te paraqitura ne Statutin dhe Rregulloren perkatese.<br><br>Kriteri 2. Ne perberje te ketij Universiteti funksionojne kater fakultete si njesi kryesore baze dhe secili fakultet ka ne perberje departamentet si njesi baze funksionale me qendrat perkatese te kerkimit dhe zhvillimit.<br>Fakulteti i Shkencave Mjekesore<br>Fakulteti i Shkencave Shoqerore<br>Fakulteti i Shkencave te Aplikuara dhe Ekonomike.<br><br>Kriteri 3. Fakulteti i Shkencave Shoqerore perbehet nga<br>Departamenti i shkencave juridike<br>Departamenti i Shkencave Politiko-administrative .<br>Departamenti i Psikologjise se Pergjithshme<br>Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes.<br><br>Kriteri 4. Njesite baze si fakulteti dhe |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5** Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor". | departamenti funksionojne ne baze te rregulloreve te vecanta ku percaktohen objektivat e veprimtarise , misioni e detyrat e seciles njesi.<br><br>Kriteri 5. Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative ne perberje te se cilit eshte edhe njesia e Programit Master ne "Studime mbi Sigurine" ka ne perberje te tij 7 anetare efektive si personel akademik ,nga te cilet 3 jane me graden Doktor i shkencave. |
| **Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve; | Kriteri 1. Njesia baze mesimore akademike per Programin Master Profesional ne "Studime mbi Sigurine" , ka deshmuar perpjekje serioze per te realizuar me nivel cilesor programin , qe studentet te fitojne njohurite e shprehite e duhura per kualifikim e tyre profesional ne perputhje me detyrat dhe kerkesat e kohes .Ne perzgjedhjen e stafit mesimdhenes te programit eshte treguar kujdesi i duhur qe ata te plotesojne kerkesat e ligjit per Arsimin e Larte te jene profesioniste me kualifikim te larte shkencor dhe pervoje shumevjecare ne profilet e tyre ,te kene kontribute ne fushen e shkences e te botimeve |
| **Kriteri 2** Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij. | Kriteri 2. Njesite baze si rregull jane perfshire ne rekrutimin e personelit akademik te nevojshem per realizimin e detyrave te percaktuara ne statut dhe rregullore .<br>Ne rastin e njesise se programit Master Profesional ne Studime mbi Sigurine eshte arritur qe te terhiqen pedagoge me kualikimin e duhur shkencor dhe me ekspertize profesionale te larte ne fushat e sigurise nga Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit, Sherbimet Intiligjente. |
| **Konkluzionet e vlerësimit:**<br>Institucioni" Albanian University" paraqet nje strukture mesimore te mirestrukturuar ne perputhje me kerkesat e Ligjit per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise nr 9741 dt 22.05 .2007 i ndryshuar, dhe me Statutin dhe Rregulloren e funksionimit te tij.<br>Te gjitha njesite perberese te universitetit veprojne ne baze te rregulloreve te vecanta si fakultetet ashtu dhe departamentet.<br>Ne rastin e programit Master Profesional ne" Studime mbi Sigurine" si fakulteti i Shkencave Shoqerore ashtu dhe Departamenti i Shkencave Administrative –Politike, pjese perberese e te cilit eshte , operojne mbi bazen e regulloreve te miratuara nga instancat drejtuese dhe perzgjedhja e stafit akademik eshte realizuar ne perputhje me ligjin per Arsimit e Larte te Republikes se Shqiperise.<br>Ne zyren e e burimeve njerezore te ketij insitiitucioni disponohen te dhena te plota per personelin mesimdhenes, shkollimin, kualifikimin, karrieren dhe pervojat akademike e profesionale te stafit mesimor te programit master. | |

## 4. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference**: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për

Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

**Stafi akademik I programit Master Profesional "Studime mbi Sigurine" perbehej nga 2 pedagoge efektive dhe 7 pedagoge me kontrate, eksperte dhe profesioniste te fushes se sigurise me tituj dhe grada akademike si Prof. Asc.Dr, Doktori i Shkencave, Master i Shkencave, ose pedagoge ne proces doktorimi**. Pedagoget me kontrate kane dorezuar dosjet personale dhe rekrutimi eshte kryer me konkurim te hapur sipas ligjeve ne fuqi. Shperndarja e ngarkeses mesimore eshte realizuar konform ligjit dhe eshte realizuar sipas programit te lendeve. Ngarkesa mesimore e mbuluar nga pedagoget efektive per vitin akademik 2011-20212 ka qene 31%, ndersa e pedagogeve me kontrate 69%. Keshillohet qe ne rast se do te kete vazhdimesi te programit ne te ardhmen, lipset qe te rritet mbulesa e programit me pedagoge te brendshem. Kjo do te shtronte detyren qe ne realizimin e programit te angazhohen si staf mesimor asistentet e lektoreve, te rinj. Ne realizimin e ketij programi, mungonte pozicion i asistentit te lektorit, per pjesen e seminareve dhe puneve seminarike.

**<u>Vlerësimi i Treguesve të matshëm:</u>**

☑ Eksperti përshkruan gjëndien e konstatuar në Institucion në Raport me të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues (**Tabela 1 dhe 2 në RVB**). Eksperti evidenton ndryshimet dhe shprehet nëse ka ndyshime dhe sa këto ndryshime ndikojnë në përmbushjen e standardeve që lidhen me këta tregues (**tabela 1 dhe 2 në Aneksin 1 dhe 2 bashkangjitur këtij Raporti**).

Nga sa konstatuam pas shqyrtimit ne vend te dokumentacionit dhe takimeve me stafin akademik nuk na rezulton te kete ndryshime midis te dhenave te deklaruara ne Raportin E Vleresimit te Brendshem RBV per keta tregues (Tabela 1 dhe 2 te RBV)me gjendjen faktike te tyre ne institucion.

☑ Struktura didaktike (seksionet) për departamentet ose programin e studimit

Programi studimor Master Profesional "Studime mbi Sigurine" ben pjese ne Departamntin e Shkencave Politiko- Admnistrative si njesi baze e Fakultetit te Shkencave Shoqerore te gjitha njesite baze te ketij Fakulteti operojne me nje rregullore te vecante ku percaktohen objektivat dhe misioni i departamentit.,

☑ Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Aneksi 1- 2, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)

Ne Programin studimor Master Profesional "Studime mbi Sigurine" jane angazhuar 2 pedagoge efektive PAE me graden Master i shkencave dhe Doktor dhe 7 pedagoge me nontrate PAK me grada e tituj Prof As.Dr, Doktor i shkencave, Master shkencor. Ne kete program studimor jane angazhuar 9 pedagoge me tituj dhe grada shkencore.

☑ Eksperti përshkruan gjëndien e konstatuar në Institucion në Raport me të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues (**Tabela 3 dhe 4 në RVB**). Eksperti evidenton ndryshimet dhe shprehet nëse ka ndyshime dhe sa këto ndryshime ndikojnë në përmbushjen e standardeve që lidhen me këta tregues (**Tabela 3 dhe 4 në Aneksin 3 dhe 4 bashkangjitur këtij Raporti**)

Konstatohet se nuk ka ndryshime midis gjendjes se konstatuar nga Grupi i Vleresimit te Jashtem me te te dhenat qe paraqiten nga Grupi i Vleresimit te Brendshem GBV per keta tregues( Shiko tabela 3 dhe 4 te RBV) Sic u shprehem me lart programi studimor ka funksionuar vetem nje vit akademik dhe nuk te dhena te tjera .

☑ Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatori/ët e programit të studimit (shih Aneksi 3)

Koordinatore e programit studimor eshte znj Alketa Marku pedagoge me graden shkencore Doktor i Shkencave, perfunduar studimet jashte vendit

☑ Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (plotëso Tabelën 4)

Ne stafin akademik te programit master profesional bejne pjese 1 Prof As dr , 4 Doktore shkencash, 2 Master shkencor ne proces doktorimi

☑ Të dhënat sipas seksit

Ne stafin akademik te programit nga 9 pedagoge , tre jane femra

☑ Të dhëna sipas moshës së personelit

Stafi akademik i programit eshte : 2 pedagoge te moshes 35-45 vjec, 3 pedagoge te moshes 46-55 vjec dhe 2 pedagoge te moshes 56-65 vjec.

☑ Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Stafi akademik i programit studimor Master Profesional ne Studime mbi Sigurine ka nenshkruar kontratat e punes. Personeli akademik para se angozhohet ne pune i nenshtrohet nje periudhe prove tremujore, me pas nenshkruhet kontratae punes per nje periudhe te caktuar ,jo me shuime se nje vit, me te drejte perseritje.

☑ Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Nuk ka te dhena per cilesine e stafit ndihmes akademik per kete program studimi. Nuk disponohen te dhena per stafin ndihmes te ketij programi studimor.

☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Ne institucion patem ne dispozicion materialet e nevojshme.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| **Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre; | Kriteri 1. Personeli akademik ,ndihmes mesimor shkencor dhe administrativ eshte i angazhuar ne perputhje me objektivat e programeve te studimeve per nje realizim sa me cilesor te tyre. Ata ne baze te statutit, rregulloreve te institucionit dhe te njesive baze si dhe te kontratave individuale te punes kane detyra dhe pergjegjesi te caktuara. |
| **Kriteri 2** Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit. | Kriteri 2. Personeli i ketij institucioni eshte angazhuar per realizimin e objektivave te percaktuara ne" Strategjine e zhvillimit institucional per periudhen 2013-2017". |
| **Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.** | |
| **Kriteri 1** Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve; | Kriteri 1. Personeli akademik eshte angazhuar ne procesin e hartimit te kurikules se programeve te studimit, te diskutimit ne procesin e realizimit te tyre dhe analizen e rezultateve, me qellim permiresimin dhe rifreskimin e tyre. |
| **Kriteri 2** Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. | Kriteri 2. Rekrutimi i personelit te ri dhe percaktimi i ngarkeses mesimore behet ne perputhje me aktet ligjore ne fuqi. Do te ishte e aresyeshme qe per personelin e ri dhe me stazh te paket profesional te caktohej pozicioni i asistentit, me qellim pergatitjen e tyre per pozicionin e lektorit te lendes. Kjo do te ndikonte ne |

| | |
|---|---|
| | pergatitjen dhe kualifikimin e nevojshem prane titullareve te lendes te nje kontigjenti te ri qe do te siguronte nje proces me efektiv ne leksione e seminare te cilat sic konstatuam jepeshin nga te njetet titullare. |
| **Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;<br><br>**Kriteri 2** Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;<br><br>**Kriteri 3** Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;<br><br>**Kriteri 4** Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj. | Kriteri 1. Institucioni ndjek procedura ligjore transparente per rekrutimin e personelit mesimor ne perputhje me statutin dhe regulloren perkatese. Njoftimet per staf akademik te kualifikuar behen te njohura ne mediat publike dhe ne web-site e" AU" ne prag te celjes se vitit akademik.<br><br>Kriteri 2. Personeli akademik i punesuar me kohe te plote per programet Master Profesional perben 30% dhe personeli i jashtem akademik rreth 70%..<br><br>Kriteri3. Universiteti" AU" ka ndjekur procedura ligjore dhe transparente per vleresimin e personelit akademik te punesuar ne programin Master "Studime mbi Sigurine".<br><br>Kriteri 4. Ne Institucion disponohet nje baze e mire te dhenash per rekrutimin e personelit akademik. Ne zyren e burimeve njerezore administrohen dosjet e plota te personelit akademik te programit Master "Studime mbi Sigurine" |
| **Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.** | |
| **Kriteri 1** Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin "Profesor i asociuar" ose, gradën shkencore "Doktor" ("PHD") të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;<br><br>**Kriteri 2** Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve "Master i Shkencave" ka të paktën gradën shkencore "Doktor";<br><br>**Kriteri 3** Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve "Master profesional" ka të paktën gradën shkencore "Doktor" ose, diplomën "Master Profesional" ose "Master Shkencash" dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studim<br><br>**Kriteri 4** Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;<br><br>**Kriteri 5** Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale. | Kriteri 1. Pergjegjesi i Programit Master Profesional ka graden shkencore Doktor (PhD)te fituar prane universiteteve europiane<br><br>Kriteri 2. Titullaret e lendes ne programin e Studimit Master Profesional "Studime mbi Sigurine" kane graden shkencore Doktor i Shkencave Prof.As. Doktor ose Master Shkencash dhe pervoje akademike se paku 5 –vjecare mesimdhenie ne arsmin e larte.<br><br>Kriteri 3. Rektori, zv rektori, dekani, zv dekani pergjegjesi i departamentit dhe i programit respektiv jane te punesuar me kohe te plote.<br><br>Kriteri 4. Institucioni "AU" siguron personel te mjaftushem per udheheqjen dhe mbikqyrjen e praktikave profesionale te studenteve te progamit Master Profesional " Studime mbi Sigurine".<br>Zyra e Karrieres dhe e praktikave mesimore qe funksionon ne kete institucion sherben per vendosjen e kontakteve dhe ndjekjen e praktikave mesimore te studenteve duke patur me institucionet ku kryhet praktika nje komunikim te ndersjellte<br><br>Kriteri 5. Ne rastin konkret, te studenteve te programit studimor Master Profesional "Studime mbi Sigurine", praktika profesionale eshte kryer ne institucionet ku ata ishin te punesuar. Ne perfundim te praktikes, studenti dorezon ne |

| | |
|---|---|
| | departament dosjen e praktikes. |
| **Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.** | |
| **Kriteri 1** Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;<br><br>**Kriteri 2** Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore "Doktor";<br><br>**Kriteri 3** Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane. | Kriteri 1. Studentet qe ndoqen pragramin e studimit Master Profesional "Studime mbi Sigurine" kane patur udheheqes per punet kerkimore dhe temen e diplomes pedagoge me tituj dhe grada shkencore.<br><br>Kriteri 2. Udheheqesi shkencor i punimeve te diplomes kane graden Doktor i shkencave dhe Prof As Doktor.<br><br>Kriteri3. Udheheqesit e punes kerkimore shkencore ne kete program, nuk kane patur me shume 3-4 studente ne kryrjen e temave shkencore te diplomes. |
| **Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.** | |
| **Kriteri 1** Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.<br><br>**Kriteri 2** Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza. | Kriteri 1. Fusha studimore kerkimore ne te cilen eshte specializuar udheheqesi shkencor perkon me lendet e programit studimor master profesional ne "Studime mbi Sigurine".<br>Kriteri 2. Udheheqesit e punimeve shkencore te ketij pragrami jane specialiste dhe eksperte te njohur te fushes se sigurise dhe zoterojne ekspertizen e nevojshme per aftesimin e studenteve ne specialitetet e sektoreve te sigurise kombetare |
| **Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbatjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë. | Kriteri 1. Institucioni" AU" ka angazhuar ka nje personel ndihmes mesimor shkencor per realizimin e programeve studimore ne oret laboratorike.Ne patem rastin tone te njohim laboratorin e teknologjise se informacionit, ku zhvilloheshin oret e laboratorit te programit master profesional<br><br>Kriteri 2. Ne institucion funksionmon Zyra qendrore e burimeve njerezore, sekretaria mesimore, zyra e kancelarit dhe njesite perkatese te programeve studimore master profesional, te cilat jane te angazhuara per perdorimin sa me optimal te burimeve njerezore ne rritjen e nivelit cilesor te procesit mesimor dhe perzgjedhjen adekuate te stafit akademik. |
| **Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.** | |
| **Kriteri 1** Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;<br>**Kriteri 2** Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore. | Kriteri1. Personeli akademik realizon ngarkesen mesimore te percaktuar ne aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi<br><br>Kriteri 2. Ngarkesa mesimore personelit akademik ne lendet programit mesimor ne Master Profesional "Studime mbi Sigurine" vleresohet me ore mesimore. |
| **Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.** | |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit; | Kriteri1. Nga kontakti tone me zyren e burimeve njerezore konstatuam se disponohet nje baze e plote te dhenash per personelin akademik te angazhuar ne programin Master profesional "Studime mbi Sigurine". |
| **Kriteri 2** Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ; | Kriteri 2. Institucioni disponon listen e plote te te personelit akademik te angazhuar ne procesin mesimor per secilin semester ,ku perfshihet personeli akademik dhe administrativ |
| **Kriteri 3** Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik. | Kriteri 3. Institucioni publikon rregullisht on-line ne ëebsitin e tij dhe ne televizionin privat UTV kerkesat per staf akademik se bashku me kriteret dhe proceduarat e kerkuara per rekrutimin e personelit akademik te nevojshem |

**Konkluzionet e vlerësimit:**
Ne institucion e arsimit te larte Albanian University jane planifikuar dhe dhe jeteresuar politika te drejta per rekrutimin e personelit akademik me nivel te kenaqshem cilesor shkencor e profesionalt te afte per te permbushur objektivat e programeve studimore. Perzgjedhja dhe rekrutimi i tyure eshte kryer permes procedurave transpartente ne perputhje me statutin dhe rreegulloren e institucionit. Personeli akademik perballon ngarkesa optimale si ne mesimdhenie ashtu dhe ne drejtimin e punimeve shkencore sic percaktohet ne aktet ligjore dhe nenligjore ne sistemin a arsimit te larte.
Institucioni disponojn te dhena te plote per personeloin akademik te angazhuar ne programin Master Profesional "Studime mbi Sigurine". Meqenese ky master ka funksionuar vetem per nje cikel te plote, nuk patem referenca per te ndjekur ne vijimesi politikat e rekrutimit dhe angazhimit te personelit perkates akademik.

## 5. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference**: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat

**Infrastruktura e Institucioni ku eshte zhvilluar programi studimor Master mbi Sigurine eshte moderne, klasat dhe mjediset mesiomore kane hapesirat te medha, te pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike, kompjuter, videoprojektore ekrane te medha**; Universiteti ka sitin e vet dhe eshte i konektuar me institu cione omologe ne vend ne rajon.
**Salla e bibliotekes ka nje fond librash e tekstesh** mesimore universitare, botime shkencore ne gjuhen shqip dhe te huaj, interneti eshte vene ne dispozion te perdoruesve te ketyre fondeve. Ne biblioteke ofrohet sherbimi on line i cili perdoret nga pedagogest e studentet non stop. Fondi i bibliotekes eshte i informatizuar.
Ne godinen qendrore, per studentet e pedagoget ofrohen nje numur i madh sherbimesh qe facilitojne punen dhe kohen e lire e te studenteve, Pedagoget disponojne bibliotekat e tyre personale ne mjediset departameteve te cilat jane te bollshme dhe te pajisura mire invetarin e nevojshem.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

☑ Eksperti përshkruan gjëndien e konstatuar në Institucion në Raport me të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues. Eksperti evidenton ndryshimet dhe shprehet nëse ka ndyshime dhe sa këto ndryshime ndikojnë në përmbushjen e standardeve që lidhen me këta tregues

Nuk ka ndryshime midis gjendjes se pershkruar ne Raportin e Vleresimit te Brendshem (RVB) per treguesit e matshem me gjendjen qe konstatuam gjate hartimit te raportit te vleresimit te jashtem. **Shiko Tab 7 e raportit te RVB.**

☑ Mjediset për Fakultetin e Shkencave Shoqerore dhe Fakultetin e Shkencave Ekonomike. Keto mjedise jane shfrytezuar per zhvillimin e programit studimor Master profesional ne "Studime mbi Sigurine" qe eshte inkuadruar ne Fakultetin e shkencave shoqerore.

| | | |
|---|---|---|
| • Salla për leksione | 10 | 1120.2m |
| • Klasa për seminare | 20 | 1005m |
| Salla për aktivitete promovuese | 1 | 245 m |
| • Salla për praktikë lëndore/ profesionale | 0 | 0 |
| • Laboratorë për lëndët profesionale | 0 | 0 |
| • Laboratorë informatike | 1 | 35 |
| • Salla për bibliotekë | 1 | 246 m |
| • Mjedis për fotokopjime, librari etj | 1 | 7 m |
| • Zyrë informacioni për studentët | 1 | 6 m |
| • Mjedise clodhese per studentet dhe pedagoget | 2 | 567 m |

☑ Mjediset për stafin:

Mjediset per stafin a programit studimor master profesional ne Studime mbi Sigurine kane qene ato te Fakultetit te Shkencave Shoqerorre te pershkruara ne tab. e mesiperme te RVB

☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Mjediset e ketij fakulteti u vizituan nga Grupi i Vleresimit te Jashtem.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| **Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore; | Kriteri 1. Institucioni "AU" ka nje vendndodhje te perhershme ,ne rastin konkret progami Master Profesional ""Studime mbi Sigurine eshte zhvilluar ne mjediset e korpusit kryesor ne adresen Bulv. Zogu i I , pas godines se Muzeut Historik Kombetar. |
| **Kriteri 2** Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet; | Kriteri 2. Mjediset korpusit qendrort jane ne dispoziocion te Universitetit per nje periudhe 10 vjecare. |
| **Kriteri 3** Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizmin e programeve të studimeve që ofron; | Kriteri 3. Programi Master Profesional "Studime mbi Sigurine" eshte zhvilluar vetem ne mjediset e korpusit qendror i cili disponon hapesira te pershtatshme per zhvillimin e veprimtarive mesimore sipas standarteve te kerkuara. |
| **Kriteri 4** Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj. | Kriteri 4. Institucioni ka garantuar standartet e kerkuara per zhvillimin e veprimtarive mesiomore ne kuadrin e ketij programit |
| **Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.** | |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;<br><br>**Kriteri 2** Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;<br><br>**Kriteri 3** Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;<br><br>**Kriteri 4** Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;<br><br>**Kriteri 5** Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve. | Kriteri 1. Institucioni ka sigurruar per programin master profesional Studime mbi Sigurine tekste mesimore baze te hartuara nga autore shqiptare dhe te huaj si dhe nga pedagoge te ketij program studimi.<br>Ne dispozicion te studenteve te programi jane vene leksione te shtypura specifikisht per kurikualat e reja. Per secilen lende te programit eshte parashikuar nje bibliografi me tekste dhe botime ne gjuhen shqipe dhe te huaj e koheve te fundit .Studenteve iu eshte rekomanduar nga pedagoget literatura baze e detyrushme dhe plotesuese.<br><br>Kriteri 2. Ne biblioteken e korpusit qendror ku zhvillohet programi master profesional respektiv ,gjendet literatura e nevojshme per punen e studenteve qe frekuentojne programin ,megjithate mbetet kurdohere paresore perditesimi i bibliotekes me tituj te rinj botimesh shkencore per ceshtjet e sigurise.<br><br>Kriteri 3. Ne biblioteke disponohet e rregjistruar biblioteka online QUESTIA e cila u sherben studenteve qe me asistimin e pedagogeve te gjejne adresat e duhura per gjetjen e materialeve studimore te nevojshem. I gjithe fondi i bibliotekes eshte i informatizuar.<br><br>Kriteri 4. Pergjegjesi i progamit por edhe pedagoget e lemndeve te ketij programi kane hartuar nje plan te detajuar per zerat qe do te mbuloje biblioteka QUESTIA ne ndihme te studenteve te programit<br><br>Kriteri 5. Biblioteka punon me orare te pershtatshme per studentet qe perkojne me mundesite e tyre per nje shfrytezim sa me te mire te fondeve te saj Ora 8am – 16 pm. |
| **Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;<br><br>**Kriteri 2** Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;<br><br>**Kriteri 3** Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;<br>**Kriteri 4** Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike. | Kriteri 1. Institucioni "AU" deshmon se ka nje numur te mjaftushem klasash, zyrash, mjedise te pershtatshme te pajisura me mjetet e nevojshme elektronike dhe tekonologjine e informacionit per tu perdorur nga pedagoget dhe studentet e programitj Master Profesonal Studime mbi Sigurine.<br><br>Kriteri 2. Konstatuam se pajisjet e mjediseve mesimore jane te pershtatshme per mesimdhenien dhe te nxenit e studenteve.<br><br>Kriteri 3-4. Institucioni disponon nje laborator informatike special per tu ardhur ne ndihme studenteve te ketij programi ne gjetjen e informacioneve nga fusha e rendit dhe e sigurise.per hartimin e puneve te pavarura sipas lendeve te programit dhe hartimin e punimit te diplomes. |
| **Konkluzionet e vlerësimit:**<br>Nga kontakti drejperdrejte me mjediset mesimore ku eshte realizuar programi Master Profesional Studime Mbi Sigurine konstatuam se ato i kane sherbyer pergatitjes mesimore dhe studimore te studenteve, kane nje inventar te mire te pajisjeve te nevojshme te teknologjise kohes si ne mjediset mesiore, klasa, auditore, laboratore ashtu dhe anekset parashikuara per sherbime te tjera si sekretaria, bibloteka, salla leximi, mjedise per kohen e lire per studentet dhe stafin akademik etj. | |

Institucioni ka nje fond te mjaftushem botimesh, tekstesh universitare revistash ne gjuhen shqipe dhe te huaj, biblioteken elektronike QUESTIA, te vena ne dispozicion te studenteve te departamentit ku ben pjese edhe programi respektiv. Por, meqenese ky program u aplikua vetem per nje cikel studimesh, fondi respektiv ne biblioteke tashme eshte i tejkaluar.

## 6. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference**: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

☑ Eksperti përshkruan gjëndien e konstatuar në Institucion në Raport me të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues. Eksperti evidenton ndryshimet dhe shprehet nëse ka ndyshime dhe sa këto ndryshime ndikojnë në përmbushjen e standardeve që lidhen me këta tregues

Institucioni ka nje raport financiar per cdo vit buxhetor te hartuar dhe te certifikuar nga eksperte te jashtem,ku permblidhen te dhena te hollesishme per te ardhura nga tarifat e shkollimit, per pagat, sigurimet shoqerore e shendetesore, tatimin mbi te ardhura personale, shpenzimet operative etj.

Sipas te dhenave te raportit finaciar IAL- AU ka aritur te mbuloje me kosto financiare te gjitha sherbimet e kerkuara dhe nderkohe ka hequr tarrifen e rregjistrimit per te gjithe studentet e te mos aplikoje te tjera tarifa shtese per provbimet etj.

Burimet finmaciare jane ato qe lidhen me tarifat e shkollimit te studenteve Rretjh 1/3 e ketyre burimeve te te ardhurave shpenzohet per qerane e objektit dhe sherbime te tjera te lidhura me mirembajtjen e tij.

Te ardhurat dhe finacimet in AU regjisytrohen dhe auitohen mbi bazen e nje numuri unik identifikuas NIPT te leshuar nga QKR.

Duhet te pemendim se treguesit per te ardhurat dhe finacimet nuk behen sipas programeve studimore pasi Institucioni ofron rreth 49. Per kete arsye keta tregues do te pasqyrohen ne vijim sipas evidencave financiare te institucioni per e vite finanaciare 2011- 2013. Programi master profesional Studime mbi Sigurine ka funksionuar gjate viti akademik 2011 2013, shiko tabela 8 ne aneksin e materialit te GVB

Te ardhurat nga tarifat per dhe gjate shkollimit (tab 8)

| | |
|---|---|
| Viti 2010-2011 | 923.000 000 |
| Viti 2011-2012 | 1.200.000.000 |
| Viti 2012-2013 | 1.136.700.000 |

☑ Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi **(në përqindje):**

Nuk ka te dhena financiare te specifikuara per kete program studimi sikunder edhe per programet e tjera studimore.

- Grantet për kërkim
- Konsulencat, shërbimet
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit
- Sponsorizimet
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)
- Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)

☑ Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Nuk ka te dhena te spcifikuara per kostot e nje studenti te ketij programi master.

☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Ne institucion ka nje raport auditi financiar per periudhen 2011-2012 kur ka funnksionuar ky program studimor, por nuk ka te dhena specifike financiare per secilin nga 49 programet studimore qe ofrohen ne kete Universitet

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| **Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.** | |
| **Kriteri 1** Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë; | Kriteri 1. Institucioni harton per cdo vit f raportin finaciar te shoqerise ne te cilin parashikohen te dhena te hollesishme finaciare per te ardhurat dhe shpenzimeve sipas zerave .Ky raport disponohet ne zyren e financave te Universitetit |
| **Kriteri 2** Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë; | Kriteri 2. Raporti i auditit permban te dhena per hollesishme per veprimtarine financiare te universitetit ,perfshire edhe programet e studimit ,grantet per kerkim sherbimet tarifat per dhe gjate shkollimit etj |
| **Kriteri 3** Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh. | Kriteri 3. Raporti i auditit analizon gjitashtu edhe perdorimin eficient te perdorimit tete ardhurave nga tarifat e studenteve ne funksion te rritjes se cilesise se studimeve master .Universiti ofron ne teresi 69 programe masteri |
| **Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj. | Kriteri1. Institucioni "Albanian University" harton nje raport te pervitshem me te dhena te hollesishme per kostot financiare te veprimtarive qe kryen dhe deshmon se ka nje situate te qendrushme financiare cka reflektohet me rritjen e numurit te studenteve dhe shtimin e programeve te studimit. |
| **Kriteri 2** Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen. | Kriteri 2. Institucioni sipas raportit financiar te auditit per tre vitet e fundit 2010 -2013, deshmon sa ka nje gjendje stabel te treguesve finanaciare dhe disponon potenciale te reja per permiresimin e metejshem te tyre. |
| **Konkluzionet e vlerësimit**<br>Sipas te dhenave te raportit te auditit te jashtem per periudhen kohore qe funksionoi programi master profesional 2011-2012, situata financiare e institucionit paraqitej stabel. Edhe sot sipas raporteve te auditit, situata financiare eshte e qendrushme dhe ofron mundesi per permiresim te treguesve kryesore.<br>Por sic konstatohet duhet te kete nje pasqyrim me te detajuar per bilancet e secilit program studimor.<br>Raportet e auditit financiar jane te depozituara ne zyren e financave. Sikunder del nga keto raporte institucioni nuk perfiton asnje grant te huaj te perfituar per kontratat e sherbimeve | |

## 7. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference**: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

**Ne IAL** – Albanian University, sistemi i brendshem i sigurimit te cilesise funksionon ne nivel njesie baze, te departamentit, ku ne fillim te vitit mesimor akademik, gjate viti, dhe ne perfundim te tij analizohen testohen dhe nxiren perfundime per programet mesimore, cilesine e punes se pedagogeve, per pergatitjen e studenteve etj.
Procesi i kontrollit dhe vleresimit te cilesese realizohet ne baze te treguesve statistikore qe sigurohen nga anketimet, pyetsoret, testimet, raportet semestrale dhe vjetore te punes se departamenteve te studenteve.
**Keto te dhena perqendrohen ne zyren e e sigurimit te brendshem te cilesese e cila funksionon ne nivel Universiteti.**
**Zyra e Brendshme e Sigurimit te Cilesise harton politikat dhe metodologjine qe perdoret per njohjen reale te treguesve te cilesise, menyren e perpunimit te te dhenave dhe nxjerjen e perfundimeve, marjen e masave per permiresimin e ketyre treguesve ne te ardhmen.**
**Kjo zyre eshte nje organ i pavaur qe ka akses per grumbullimim e informacione nga te gjitha njesite baze dhe eshte ne varesi te drejtperdrejte te Rektorit te Universitetit**. Zyra publikon nje raport vjetor ne te cilin perfshihen informacine dhe te dhena per cilesine e procesit te mesimdhenies dhe te nxenit, per cilesine e punes mesimore ne programe te ndryshme, per cilesine e sherbimeve akademike dhe administrative qe ofrohen, dhe rekomandon masat per permiresimin e parametrave te cilesise.
Raporti vjetor i prezantohet Rektorit i cili ia paraqet Senatit akademik per diskutim dhe miratim. Funksionet dhe detyrat e ZSBC parashikohen ne nenin 13 te Rregullores se Brendshme te IAL Albanian University.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

☑ Eksperti përshkruan gjëndien e konstatuar në Institucion në Raport me të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues (**Tabela 5 në RVB**). Eksperti evidenton ndryshimet dhe shprehet nëse ka ndyshime dhe sa këto ndryshime ndikojnë në përmbushjen e standardeve që lidhen me këta tregues (**tabela 5 në Aneksin 5 bashkangjitur këtij Raporti**)

Konstatoj se nuk ka ndryshime midis te dhenave te paraqitura ne raportin e Grupit te Vlersimit te brendshem RBV te IAL Albanian Univëersity me ato te konstatatuira nga ne gjate pergatijes se ketij Raporti Vleresimi te Jashtem

☑ Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
- o Sa anketime kanë bërë me studentët
- o Jane kryer 2 anketime me studentet e programit Studime mbi Sigurine .
- o Sa studentë janë anketuar? Jane anketuar 45% e numurit te pergjithshem te stiudenteve
- o Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dale? Jane perpunuar te gjitha tedhenat e anketimeve dhe jane nxjere treguesit statistikore sasiore dhe cilesore
- o Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm? Mbi bazen e ketyre treguseve jane propozuar masat per perniresimin e situates .nga ana e dapartamenteve mesimore.

☑ Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Kontrolli i brendshem io cilesise kordinohet nga ZSBC ne nivel Universiteti .Kjo zyre perbehet nga keta punonjes

1. Elona Mehmeti drejtuese , 5 vite pune ne njesi
2. Klotilda Dauti anetare 1 vit pune ne njesi
3. Leudita Docaj anetare 3 vite pune ne njesi.

☑ Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Ne programin studimor Master profesional "Studime mbi Sigurine" funksionon Grupi i Vleresimit te Brendshme me kete perberje

1. Dr. Alketa Marku
2. Dr .ne proces, Dorjana Pano
3. Kole Kukaj, student i masterit

☑ Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Programi Studimor Master Profesional "Studime mbi Sigurie ka funksionuar 1 vit mesimor akademik 2011-2012 dhe te dhenat ne raportin e Grupit te Vleresimit te Brendshem i perkasin ketij viti.

☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Ne institucion morem dokumenetacion shtese per punen e ZSBC qe sherbeu edhe hartimin e Raportit tone te Vleresimit te Jashtem.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| **Standardi/Kriteret** | **Vlerësimi sipas standardeve** |
|---|---|
| **Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve; | Kriteri 1. Institucioni" AU" ka ne qender te vemendjes sigurimin e nje cilesie te larte te pergatitjes se studenteve ne programet studimore. Sigurimi i cilesise realizohet permes angazhimit te drejtperdrejte te stafit akademik ne mesimdhenie me tregues cilesore,por edhe kontrollit dhe ndjekjes sistematike te cilesise se procesit,nga ana e Zyres se Sigurimit te Brendshem te Cilesise (ZSBC) e cila funksionon ne nivel qendror, por edhe e njesive te tjera te omonime ne nivel departamenti.<br>Institucioni permes ZSBC perdor instrumente matese te standartizuara per ecurine e programit te studimeve. |
| **Kriteri 2** Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë; | Kriteri 2. Zyra e Sigurimit te Brendshem te Cilesise eshte nje organ i pavarur i cili ka akses ne te gjitha informacionet qe vijne nga departamentet dhe njesite e programeve studimore mbi realizimin e objektivave dhe standarteve te kerkuara ne mesimdhenie dhe mesimnxenie. Ky informacion kontrolli dhe vleresimi vjen permes te dhenave statistikore te vjela nga anketimet e studenteve, raporteve semestrale te pedagogeve dhe atyre vjetore te departamenteve si dhe rezultateve te arritura nga studentet e programeve studimore.<br>Informacioni i siguruar nga raportet semestrale perdoret per vetvleresimin e objektivave te programeve studimore qe ofron Universiteti. |
| **Kriteri 3** Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë; | Kriteri 3. Zyra e mesiperme ka per detyre te paraqese nje raport vjetor mbi cilesine e procesit mesimor dhe vleresime per procesin e mesimdhenies dhe mesimnxenies ,per nivelin e kerkimit shkencor, cilesine e punes se stafit akademik duke i propozuar Rektorit te |
| **Kriteri 4** Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta. | |

| | |
|---|---|
| Të tërthorta:<br>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;<br>b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;<br>c. Pyetje konceptuale;<br>d. Intervista;<br>e. Etj.<br><br>Të drejtpërdrejta:<br>a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);<br>b. Dëgjime në auditor;<br>c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;<br>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;<br>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);<br>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;<br>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;<br>h. Etj. | Universitetit masa per permiresimin e treguesve te cilesise se veprimtarise se ketij institucioni Universiteti publikon regullisht raportet mbi sigurimin e brendshem te cilesise dhe detyrat e masat per permiresimin e vazhdushem te saj.<br>Keto raporte vjetore qe behen objekt diskutimesh ne Senat i sherbejne nje analize me te detajuar te programeve studimore dhe analizes SËOT dhe japin rekomandime per ecurite e metejshme te ketyre programeve.<br><br>Kriteri 4. Institucioni mepermjet ZSBC perdor metoda te drejtperdrejta dhe indirekte te vleresimit. Metoda te drejtperdrejta. Rezultatet e studenteve ne teste te standartizuara, rezultatet e studenteve ne provime, rezultatet ne punet e pavarura dhe punimin e diplomes,<br>Metoda indirekte, kryerja e sondazheve, anketimeve, intervistave me studente te programeve te studimit mbi mesimdhenien, cilesine e stafit akademik.<br>Te dhenat e nxjera nga aplikimi i metodavete mesiperme sherbejne per njohje e gjendjes dhe marrjes se masave per permiresimin e punes ne kuadrin e realizimit te objektivit per nje aftesim sa me te mire te studenteve ne programet studimore Master Profesional. |
| | |
| **Kriteri 1** Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm. | Kriteri 1. Institucioni AU ne broshurat qe publikon prezanton te dhena dhe informacion burimor nga njesite e sigurimit te brendshem te cilesise te cilat sherbejne per njohjen e gjendjes dhe te masave qe merren per rritjen e niveli te cilesise ne nivel departamenti dhe programi studimor.<br><br>Kriteri 2. Institucioni publikon te dhena te perditesuara per sigurimin e brendshem te cilesise sipas udhezimeve te Ministrise se Arsimit, dhe statutit e regullores se Universitetit, si dhe te APAAL-it |
| **Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë. | Kriteri 1. Institucioni harton nje analize vjetore per ecurine e programeve te studimit "Master Profesional", ne rastin konkret ka nje raport vjetor per ecurine e Masterit Profesional "Studime mbi Sigurine", qe ka funksionuar vetem per nje cikel<br><br>Kriteri 2. Institucioni harton politika qe synojne permiresimin e programeve studimore "Master profesional" te cilat diskutohen ne departamente dhe Senatin e Universitetit. |
| **Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akreditur në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve; | Kriteri1. Institucioni "AU" ka plotesuar standartet dhe eshte akredituar ne nivel istitucional perpara aplikimit per akreditimin e pragrameve te studimit Master profesional.<br>Ne rastin konkret, Fakulteti i Shkencave Shoqerore, ne kuadrin e te cilit ka funksionuar programi "Master Profesional" Studime mbi |

| | |
|---|---|
| | Sigurine" eshte akredituar nga Ministria e Arsimit ne vitin 2010. |
| **Kriteri 2** Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë; | Kriteri 2. Institucioni perdor instrumentat e duhura per sigurimin e cilesise .Ne strukturen e tij e funksionojne organizma te posacem si Zyra e Sigurimit te Brendshem te Cilesise ne nivel qendror dhe omonimet e saj ne nivel depatamenti, te cilat sigurojen inputet e nevojshme me te dhena faktike mbi treguesit sintetike te cilesise se programeve dhe realizimit konkret te tyre ne formimin e studenteve. |
| **Kriteri 3** Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre; | Kriteri 3. Institiucioni harton politika dhe ndjek procedura te caktuara per sigurimin e cilesise te cilat jane te pasqyruara ne dokumentat baze si Statuti, Rregullorja Plani i zhvillimit institucional 2013 -2017. |
| **Kriteri 4** Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit; | Kriteri 4. Ne Universitet ka nje praktike te rregullt pune per shqyrtimin dhe miratimin e dokumentacionit mbi sigurimin e brendshme te cilesise e Rektorat, Senat dhe departamente. Ne forme rekomandimesh nga analiza e te dhenave, caktohen masat per permiresimin e metejshem te cilesise se programeve dhe te rritjes se nivelit te pergatitjes se studenteve ndjekes se ketyre programeve studimore |
| **Kriteri 5** Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to; | Kriteri 5. Ka nje synim te qarte ne detyrat e ketij Institucioni se cilesia e punes varet nga ndergjegjsesimi i stafit akademik, personelit ndihmes-mesimor por edhe te vete studenteve qe sigurimi i cilesise se brendshme kerkon detyrimisht nje bashkepunim te ngushte mes tyre. |
| **Kriteri 6** Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar. | Kriteri 6. Institucioni disponom nje strategji te veten per permiresimin e cilesise se veprimtarise se tij.<br>Strategjia e zhvillimit institucional per periudhen 2013-2017 eshte bere publike dhe bashke me te ne faqen e internetit njoftohen vendimet e marra nga organet kolegjiale per permiresimet e planifikuara ne lemin e programeve, metodave dhe teknologjise mesimore, te praktikave profesionale te studenteve etj |

**Konkluzionet e Vleresimit:** Nje komponent i rendesishem per mbarevajtjen e procesit te rritjes se cilesise se punes ne "Albanian University' eshte sigurimi i brendshem i cilesise i cili duket se eshte nje konstante e perhershme pune. Keshtu Zyra e sigurimit te brendshem te cilesise operon qe nga viti 2009 se bashku me omonimet e saj ne nivel departamenti siguron nje informacion te gjere mbi cilesine e realizimit te programeve studimore dhe nivelin e pergatitjes teoriko praktike te studenteve , mbi angazhimin faktik te stafeve akademike ne rritjen e cilesise se mesimdhenies, perditesimit te kurikkulave dhe moduleve lendore me novacionet ne fushen e informacionit dhe teknologjive didaktike. Organizmat qe sigurojne se brendshmi cilesine e kerkuar perdorin metoda dhe instrumenta shkencore per vjeljen e te dhenave nga studentet dhe stafi akademilk dhe te perpunuara ne formen e raporteve ia paraqesin Rektorit dhe Senatit per te dhene rekomandimet per permiresimet qe duhen bere ne praktiken mesimore per secilin program studimor.Zyra e sigurimit te brendshem te cilesise ka nje bashkepunim te hershem me APAAL-in, ne trajnimin e stafeve akademike per sigurimin e standarteve te cilesise ne Universitetin " AU".

## POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

## 8. Programi i studimit, organizimi i tij

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference**: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi i studimit Master Profesional "Studime mbi Sigurine" u adresohet studenteve te diplomuar ne arsimin e larte te interesuar te thellojne formimin profesional ne fushen e sigurine kombetare dhe nderkombetare, te rrisin aftesite dhe kapacitetet ne ekspertizen e tyre per sfidat e reziqet me te cilat perballet bota sot.
Programi i lendeve ne kete master, parashikon njohuri teorike te thelluara per problematikat te sigurise ne plan kombetar, rajonal e global, per institucionet e sigurise politikat e praktikat e tyre,legjislacioninn ku mbeshtetin veprimtarine e tyre.
Ne program i kushtohet kujdes i vecante mbrojtjes se sistemit te vlerave njerezore, respektimit te liriive dhe te drejtave te njeriut edhe ne kushtet e aplikimit te masave te vecanta te sigurise.
Programi synon ne pajisjen e studenteve me njohuri te reja per luften kunder krimit te organizuar, terrorizmit, korupsionit,te nevojshme per te analizuar fenomenologjine komplekse te tyre dhe per te adoptuar masa adekuate per parandalimin dhe eliminimin e shkaqeve qe i lindin dhe pasojave qe mbartin.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

☑ Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit Master Profesional "Studime mbi Sigurine" u zhvillua pergjate nje viti mesimor Akademik 2011-2012 ne kuadrin e Fakultetit te Shkencave Shoqerore te ketij Universiteti.

☑ Organizimi i çdo programi studimi (vite, semestra, javë etj.)

Programi i ketij masteri zgjat nje vit e gjysem akademik me tre semestra me nje total prej 90 kreditesh ECTS.Leksionet zhvillohen ne auditore dhe zene nje total prej 20 oresh ne jave.Forma e studimit eshte me kohe te plote dhe frekuentimi eshte i detyrushem ne masen 75% te aktiviteteve formuese ne auditor.
Programi i ketij Masteri eshte i ri dhe nuk perserit programet e studimit te ciklit te Dyte (MND) te ofrura me pare nga IAL-Albanian University.
Disiplinat mesimore te programit si dhe veprimtarita e tjera formuese organizohen ne pese kategori nga A te F. Nga keto, disiplintat mesimore te ktg. A.B.C.E jane lende te detyrushme. Gjate vitit te dyte te studimeve (semestrit te III-te) studenti pergatit temen e diplomes te cilen e mbron si kusht per diplomim ne Master Profesional.

- 1 vit akademik ka 30_____ javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15_____ javë mësimore në auditor

☑ Në Planet mësimore të jepet ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Studenti qe ndjek kete program studimor duhet te perfitoje 90 kredite nga te cilat 13 ECTS ne kategorine e displinave te formimit baze (A), : 25 ECTS ne kategorine e disiplinave kategorizuese (B), 29 kredite ECTS ne kategorine e disiplinave te formimit te ngjajshem dhe integruese : 5 kredite ECTS stazhi apo praktika profesionale: 15 kredite ECTS per punimin e temes se diplomes.

☑ Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Aneksi 6).

Nuk konstatuam ndryshime ne planet mesimore te licensuara

☑ Eksperti përshkruan gjëndien e konstatuar në Institucion në Raport me të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues (**Tabela 6 në RVB**). Eksperti evidenton ndryshimet dhe shprehet nëse ka ndyshime dhe sa këto ndryshime ndikojnë në përmbushjen e standardeve që lidhen me këta tregues (**tabela 6 në Aneksin 6 bashkangjitur këtij Raporti**)

Gjendja e konstatuar gjate ushtrimit te konstrollit per vleresimin e jashtem per keto te dhena perkon me ato qe deklarohen ne Raportin e Vleresimit te Brendshem shiko tabelen 6 te RBV bashkangjtur ketij Raporti.

☑ Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet 390 orë në auditor dhe 560 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret 195 orë në auditor dhe 530 orë punë e pavarur e studentit
- Për Laboratoret ____ orë në auditor dhe ____ orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikat lëndore ____ orë në auditor dhe ____ orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale ____ orë në auditor dhe ____ orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar ____ orë në auditor dhe 225 orë punë e pavarur e studentit

Veprimtaria mesimore zhvillohet nepermjet leksioneve tradicionale ne auditor seminareve ushtrimeve me goje e me shkrim, laboratoreve projekteve dhe detyrave te kursit, praktikave profesionale dhe oreve te parashikuara per punimin e diplomes. Leksionet e lendeve zene ne total 20 ore ne jave. Numuri total i provimeve eshte 14 nga keto 13 provime perfundimtare + 1 praktika profesionale. Per tu diplomuar kerkohet mbrojtja e punimit te diplomes. Kontrolli i dejeve dhe aftesive qe parashikon programi studimor sigurohet permes aplikimt te formave te kontrollit te vazhdueshem dhe provimit perfundimtar, me shkrim ose me goje. Veprimtarite formuese zene nje total prej 2025 oresh mesimore qe i korespondojne 90 krediteve ECTS. 585 prej te cilave jane ore ne auditor dhe 1440 ofre mesimore te shperndare gjate vitit akademik ne ore studimi individual, ore per pergatijen e temave me karakter teoriko aplikative.

☑ Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Aneksi 7)

☑ Eksperti përshkruan gjëndien e konstatuar në Institucion në Raport me të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues (**Tabela 7 në RVB**). Eksperti evidenton ndryshimet dhe shprehet nëse ka ndyshime dhe sa këto ndryshime ndikojnë në përmbushjen e standardeve që lidhen me këta tregues (**tabela 7 në Aneksin 7 bashkangjitur këtij Raporti**

Nuk ka ndryshime persa i perket te dhenave te deklaruara ne Raportin e Vleresimit te Brendshem (RBV) me gjendjen reale te konstatuar nga ana tone, Shiko tab 7 bashkangjtur ketj Raporti

☑ Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë

Tabela nr 7 permban te dhenat e kerkuara ne rubrikat e meposhtme.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

☑ Dokumentacioni përkatës, i marrë në institucion

Ne institucion patem ne dispozionon materiale shtese te nevojshme per programet politikat e zbatuarane kete program studimi.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| **Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e** | |

| tij. | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS); | Kriteri 1. Programet Master Profesional qe ofron "AU", perputhen me Strategjine e Zhvillimit Institucional te ketij universiteti. Konkretisht, Masteri profesional Studime mbi Sigurine eshte konstruktuar ne module dhe te vleresuara ne kredite, ne perputhje me standartet e kriteret e Sistemit Europian te transferimit dhe grumbullimit te Krediteve ECTS |
| **Kriteri 2** Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite; | Kriteri 2. Per Masterin Profesional "Studime mbi Sigurine", sasia e krediteve te grumbulluara gjate nje cikli te plote studimor, nje viti e gjysem akademik, te ndare ne tre semestra eshte 90 kredite |
| **Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.** | |
| **Kriteri 2** Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave", "Master i arteve të bukura" apo "Master Profesional" i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare "Bachelor" me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional; | Kriteri 2 Programi i studimeve Master Profesional ne "Studime mbi Sigurine", i pajise studentet me njohuri te thelluara per problematikat bashkohore te sigurise kombetare, rajonale e globale, rrit aftesite profesionale ne fushen e kerkimit shkencor me shprehi praktike te punes se pavarur me se te nevojshme per profilin ekspertit ne fushen e sigurise. |
| **Kriteri 3** Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukura" dhe "Master Profesional" synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve; | Kriteri 3. Programi i studimit Master Profesional ne "Studime mbi Sigurine" synon te zgjeroje dhe te thelloje njohurite e fituara nga studenti ne programet Bachelor duke shmangur perseritjet dhe mbishtresimet qe krijojne mbingarkesa. |
| **Kriteri 4** Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi; | Kriteri 4. Nuk aplikohet ne rastin e ketij programi |
| **Kriteri 5** Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij; | Kriteri 5. Programi i ketij Masteri ka per objektiv te permiresoje performancen profesionale te specialistit ne fushen e sigurise, ta aftesoje ate ne kryrjen e detyrave funksionale. |
| **Kriteri 6** Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukura" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve; | Kriteri 6. Programi i ketij masteri synon ti pajise studentet me shprehite dhe zotesise e punes kerkimore ne fushen e specialitetit, te cilat ti mundesojne aftesimin e metejshem per te ndjekur programet e ciklit te trete, Doktoratures te cilat ofrohen tashme ne institucionin "AU" |
| **Kriteri 7** Programet e studimeve "Master Profesional" kanë objektiva të qartë profesionalë, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës. | Kriteri 7. Programi Master profesional "Studime mbi Sigurine" prezantohet me objektiva te qarta, te aksesushme per studentet dhe perkon me kerkesat e tregut te punes per specialiste me kualifikim te nevojshem per perballjen me sfidat e kohes se sotme si krimi i organizuar, korrupsioni, terrorizmi, trafiqet, pastrimi i parave etj. |
| **Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato; | Kriteri 1. Permbajtja dhe renditja e ketij programi, gjykoj se perkon me nivelin e studimeve per te cilin ofrohet. Programi permban informacion te ri, njohuri dhe koncepte bashkekohore ne fushen e sigurise, nxit mendimin krijues dhe formon shprehi te kerkimin shkencor te studentet pjesemares. Nje pozitivitet te vacante ka programi ne aspektin e |

| | |
|---|---|
| | lidhjeve nderlendore, duke siguruar nje harmonizim te permbajtjes, e cila i mundeson studenteve te aftesohen ne analiza dhe sinteza te problematikave te sigurise, te cilat jane multidimensionale, si terorizmi, risqet dhe reziqet e sigurise kombetare e rajonale, lufta psikologjike, etj |
| **Kriteri 2** Metodat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve. | Kriteri 2. Ne kuadrin e realizimit te ketij programi studimor konstatohet se ka patur nje kontroll permanent te dijeve, si gjate procesit te mesimit ashtu dhe provimet e lendeve.Nepermjet zyres qendrore te sigurimit te brendshem te cilisese por edhe njesive departamentale te sigurimit te cilesise jane organizuar testime, anketime, takime me studente dhe pedagoge per te marre informacion on-spot per cilesine e mesimdhenies dhe te nxenit rezulton se jane perdorur per kete qellim- Pyetsore, anketime analize e rezultatetve te studenteve, vleresim i detyrave ne lende, projekte, detyra kursi etj. |
| **Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikat e mira të vendeve europiane; | Kriteri1. Programi Master Profesional "Studime mbi Sigurine", eshte hartuar mbeshtetur ne pervojen e perftuar nga Masteri MND mbi sigurine i cili funksionioi per 2 vite akademike prane AU.<br>Ne hartimin e programit studimor te ketij masteri jane angazhuar nje numer studiuesish dhe ekspertesh te njohur shqiptare ne fushen e maredhenieve nderkombetare e te sigurise te cilet jane mbeshtetur ne arritjet me te mira te dokumentacionit tone dhe te huaj ne kete fushe. |
| **Kriteri 2** Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e tranferimit të krediteve e njohurive të fituaara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri; | Kriteri 2. Programi i studimeve i ketij masteri rezulton se ka nje mireformatim sipas te kritereve te njohura te ECTS, por fakti se funksionoi per nje cikel te vetem, nuk le hapesire per te gjykuar per vlerat konkuruese te tij ne plan nderkombetar |
| **Kriteri 3** Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara. | Kriteri 3. Programi i mesiperm rezulton se ka respektuar objektivat e percaktuara ne legjislacionin e direktivat e BE per arsimin e larte dhe profesionet e rregulluara. Eshte ndertuar ne baze te krediteve, nxit te mesuarit mbi bazen e kerkimit, ofron mobilitet per tranferta kreditesh ne specialitetet e fushes se sigurise, afteson studentet ne pune te pavarur. |
| **Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.** | |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor; | Kriteri 1. Programi i studimit Master Profesional "Studime mbi Sigurine" permban nje komponent te rendesishem–aftesimin profesional dhe kerkimin shkencor te studentet. Keto komponente realizohen nepermjet informacionit bashkekohor te lendeve, perdorimit te metodavete te nxenit aktiv e krijues, perdorimit te teknikave dhe teknologjive te reja, sasise ne rritje te puneve te pavaruara. |
| **Kriteri 2** Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim; | Kriteri 2. Programi studimor Master Profesional "Studime mbi Sigurine" eshte hartuar ne perputhje me profilin qe ka IAL-AU, dhe me dokumentin e Strategjise se zhvillimit instititucional te tij. |
| **Kriteri 3** Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizmin e programeve të studimeve; | Kriteri 3. Personeli akademik i ketij masteri profesional eshte i angazhuar ne pune kerkimore shkencore sipas nje plani te miratuar nga departamenti perkates. |
| **Kriteri 4** Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij. | Kriteri 4. Puna kerkimore shkencore e stafit te programit eshte inkuadruar ne nivel te departamentit, dhe e fokusuar kryesisht ne hartimin dhe perditesimin e programeve lendore, ne pjesemarje ne veprimtari shkencore ne nivel universitar dhe kombetar, ne hartimin e teksteve mesimore te reja dhe te bibliografive te perditesuara. |
| **Standardi I.7 - Programet e studimeve "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës; | Kriteri 1. Programi i studimit Master Profesional "Studime mbi Sigurine" eshte disenjuar per te plotesuar disa nevoja te tregut te punes ne sektoret e rendit publik dhe sigurise per specialiste me nivel te larte pergatitje teorike e praktike, te afte per tu perballuar me problematikat e sotme te sigurise. Por mungesa e vazhdimesise se ketij programi tregoi se keto kerkesa kane qene te kufizuara per shkak te nje tregu te vogel dhe ofertes se madhe nga disa universitete publike e jopublike te cilat prezantuan simultan programe master profesional ne fushen e sigurise. |
| **Kriteri 2** Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj. | Kriteri 2. Ky program masteri i sherbeu nje kontigjenti prej 14 specialistesh te fushes se sigurise ne sektoret e Rendit publik, SHISH, SHIU, Ministrise se Drejtesise, Ministrise se Mbrojtjes per te thelluar dijet dhe shprehite ne sferen e sigurise, per ti rritur nivelin profesional perkitazi me kerkesat e kohes. |
| **Standardi I.8 – Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.** | |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;<br>**Kriteri 2** Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, I cili përfshin:<br>a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar a ndërkombëtar;<br>b. kërkesat e punëdhënësve;<br>c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;<br>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. | Kriteri 1-2. Programet e studimeve per master profesional ne "AU" marrin parasysh nevojat e tregut te punes ne vendin tone dhe in kuadrohen ne Planin e zhvillimit institucional te ketij institucioni per periudhen 2013-2017 duke marre ne konsiderate mundesite e punesimit te studenteve kryesisht ne tregun vendas e ate rajonal, kerkesat e punedhenesit, nje parashikim te perafert per numurin e pritshem te studenteve. Ne masterin profesional studime mbi sigurine eshte diplomuare edhe nje student nga Republika e Kosoves. |

**Standardi I.9 – Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.**

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interest kombëtare;<br>**Kriteri 2** Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare. | Kriteri 1-2. Programet e studimit Master profesional nuk bien ndesh me interasat kombetare, ato promovojne vlerat dhe arritjet me te mira te aresimit dhe shkences kombetare dhe mbeshteten ne traditen tone me te mire ne respektimin e te drejtave dhe lirive te njeriut,te tolerances dhe bashkejeteses harmonike fetare, ne respektin e pakicave etnike, kulturore etj. |

**Standardi I.12 – Kohëzgjatja dhe numri I krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, ren 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", I ndryshuar.**

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2** Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike. | **Kriteri 2.** Programi Master Profesional "Studime mbi Sigurine" realizohet me 90 kredite europiane ECTS . Kohezgjatja normale eshte 1,5 vite akademike te ndare ne tre semestra. |

**Standardi II.6 – Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.**

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Informacioni I ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht I konsultueshem për studentët;<br>**Kriteri 2** Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike. | Kriteri 1 -2. Studente kane patur ne dispozicion nje informacion te mjaftueshem per te njohur programin perkate, modulet dhe silabuset, stafin akademik te prezantuara ne materiale te shtypura por dhe ne forme elektronike nga sekretaria mesimore, zyra e keshillimit te karrieres etj. Web –siti i Universitetit jep nje peshkrim te detajuar te programeve te studimit qe ofrohen nga "AU" |

**Standardi II.8 – Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.**

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Plani I diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve renda afatit të parashikuar;<br>**Kriteri 2** Për realizimin e programeve të studimeve "Master I Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën. | Kriteri1. Studentet e programit informohen gjeresisht me planin e diplomimit , programet lendore kohezgjatjen e studimeve ,sistemin e krediteve dhe te transfertave, diplomen qe fitohet ne perfundim te studimeve.<br>Kriteri 2. Nuk aplikohet ne rastin konkret. |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Programi i studimit Master Profesional ne Studime mbi Sigurine eshte hartuar ne mbeshtetje te Ligjit per Arsimin e Larte ne RSH ne 9741 dt 21.05.2007 i ndryshuar ,te Planit strategjik per zhvillimin institucional te AU , ne baze te Statutit dhe Rregullores te ketij Insitucioni ,bazuar ne profilin e dhe programet studimore qe ofron, si dhe te kritereve qe rregullorja e EFTC.

Programi synon te pergatise specialiste te afte ne fushen e sigurise kombetare, me njohuri dhe shprehi pune adekuate per sfidat me te cilat perballet vendi si krimi i organizuar, terrorizmi, korupsioni, pastrimi i parave, trafiqet etj. Viti mesimor ka 30 jave, te ndare ne 2 semestra, me nga 15 jave. Ne semestrin e pare dhe te dyte parashikohen ne total 67 kredite per studentet, ndersa semestri i trete ka gjithashtu 15 jave, me 23 kredite mesimore. Ne perfundim te semestrit te trete qe sherben kryesisht per punimin e diplomes, zhvillohet sipas rregulloress ne fuqi, provimi i diplomes. Gjykoj se praktika e ndjekur per realizimin e Politikave te formimit te studenteve ne masterin profesional eshte mbeshtetur

ne legjislacionin ne fuqi dhe ka rezultuar poziteve duke marre parasysh analizen e treguesve sipas standarteve dhe kritereve te percaktuara .

## 9. Mësimdhënia

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference**: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhenies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

**Organizimi kryesor i mesimdhenies jane leksionet e pedagogeve ne baze te leksioneve te shkruara mbi tekstin baze dhe literatura e rekomanduar** .Lektori i permbahet programit mporka autonomiper te shtuar tema dhe materiale te cilat i konsidcerohen te nevojshme për nje formim me te mire te studenteve. Ne kete program studimor lendet jane semestrale dhe format kryesore te mesimdhenies jane leksionet seminaret praktikat profesionale, detyrat e kursit provimet e mesit te semstrit, punimet e kursit, temat e diplomave etj te organizuara ne moule. Numuri total i veprimtarive formuese eshte 15 ku jane parashikuar 13 provime, praktika dhe tema e diplomes.

Frekuentimi i studendeve eshte me kohe te plote dhe i detyrueshem ne masen 75%. Ne planet mesimore jane prashikuar lende te formimite baze, karakterizuese, lende te ngjajshme ose integruese.

**Ngarkesa mesimore ne leksione, seminare, e praktika per studentet eshte konform udhezimeve te nxjera nga Ministria e Arsimit dhe e Shkences ne baze te Ligjit per Arsimin e larte ne R.SH nr 9741, te dates 21**.5.2007 i ndryshuar.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

☑ Eksperti përshkruan gjëndien e konstatuar në Institucion në Raport me të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues. Eksperti evidenton ndryshimet dhe shprehet nëse ka ndyshime dhe sa këto ndryshime ndikojnë në përmbushjen e standardeve që lidhen me këta tregues

Nuk ka ndryshime ndermjet te dhenava te paraqitura ne Raportin e Vleresimit te Brendshem RBV me ato te konstatura nga ana tone gjate kontrollit te ushtruar.

☑ Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

- Leksione ore totale ne auditor 390
- Seminare " " 195
- Ushtrime
- Laboratore
- Praktikë lëndore
- Praktikë profesionale ore totale 225 ore
- Etj

☑ Format e kontrollit të njohurive

☑ Vleresimi i pergatitjes se studenteve realizohet nepermjet mekanizmit te kontrollit te vazhdueshem ku nota perfundimtare eshte rezultat i elemteve te meposhtem

Provimi perfundimtar 60 pike.

Provimi i ndemjetem 20 pike.

Pjesemarja aktive ne seminare 10 pike

Prezantimi i punes se pavarur ose ne grup 10 pike

Kontrolli i dijeve dhe studenteve realizohet permes provimeve me goje ose me shkrim detyrave te kursit dhe mikrotezave.

☑ Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Nuk ka te dhena per keta tregues ne raportin e RBV

☑ Dokumentacioni përkatës i marrë gjatë vizitave

Siguruam dokumentacion shtese per problemet e mesiperme.

## 10. Studentët

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Per te ndjekur programi studimor Master profesional "Studime mbi sigurine" e studentet studedentet duhet te kene nje diplome Bachelor apo te sistemoit te vjeter, te plotesoje kriteret akademike te vendosura nga komisioni i pranimeve te njesise baze, te paguaje tarifen vjetore. Pranimi I kandidateve per kete program studimor behet me dosje. Programin Master Profesional "Studime mbi Sigurine" ne vitin akademik 2011-2012 e frekuentuan 15 studente ,8 prej te cileve u diplomuan Brenda sezonit 3 studente u diplomuan ne sezoni e vjeshtes 2 studente kane kaluar ne stazh ndersa nje student rezulton i çrregjistruar.

Mesatarja ne hyrje e ketyre studenteve eshte me noten me noten 7,5 ndersa ne dalje eshte 9. Masteri profesiona Studime mbi Sigurine zgjati nje vit e gjysem akademik me tre semestra me nje total prej 90 kreditesh ETS Leksionet zhvillohen ne auditor me nje total prej 20 ore.

Forma e frekuentimit eshte me kohe te plote dhe frekuentimi i aktiviteteve mesimore ne auditor eshte i detyrushem ne masen 75%.

Studenti nuk pranohet ne sesionin e pare te provimit te nje lende kur kryen me shume se 25% mungesa ne seancat mesimore te asaj lende. Ne rast se ka kryer mungesa ne 50% te oreve te lendes ai pranohet ne sesionmin e dyte ndersa kur ka munguar me shume se 50% te oreve te lendes shpallet perserites ne lenden respektive.

Studentet e ketij programi sipas te dhenave qe disponohen ne sekretarine mesimore jane te gjithe te punesuar ne institucionet shteterore, te rendit publik dhe organet e sigurise. Edhe pas diplomimit ata mbajne lidhje te rregullta me Institucioni "AU", duke shkembyer informacionin te nevojshem.

**Vlerësimi i Tregues të matshëm:**

☑ Eksperti përshkruan gjëndien e konstatuar në institucion në Raport me të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues. Eksperti evidenton ndryshimet dhe shprehet nëse ka ndyshime dhe sa këto ndryshime ndikojnë në përmbushjen e standardeve që lidhen me këta tregues.

***Gjendja qe rezulton nga kontrolli i ushtruar, eshte pergjithesisht e njejte me ate te pershkruar ne Raportin e Vleresimit te Brendshem***

☑ Procedurat e pranimit të studentëve

Procedurat realizohen sipas kritereve te percakturara ne Rregulloren e depatrtamentit ku inkuadrohet programi master profesional. Pranimi behet me verifikimin e dosjeve te studenteve kandidate.

☑ Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Kontigjenti i studenteve qe ka ndjekur kete program studimi ka nje mesatare note ne hyrje 7.5 dhe ne perfundim noten 9.

☑ Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë)

Jane 15 studente te rregjistruar per here te pare ne kete master profesional

☑ Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse)

8 studente te diplomuar ne mbarim te vitit akadenik me note mesatare 9

☑ Të dhëna për punësimin e studentëve.

Studentet e diplomuar ne Masteri profesional jane punesuar ne sektoret e rendit dhe sherbimeve intiligjente te vendit.

☑ Numri total të diplomuarve.

Ne kete master u diplomuan 11 studente.

☑ Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Te 11 studentet e diplomuar ne kete program Masteri Profesional punojne ne sektore qe perputhen me diplomimin e tyre.

☑ Dokumentacioni përkatës i marrë gjatë vizitave

Ne institucion morem te dhena shtese per ceshtje te kesaj rubrike.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| **Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.** | |
| **Kriteri 1** Studentët që ndjekin programet e studimeve "Master i Shkencave" apo "Master Profesional" zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS; | Kriteri 1Programi studimor Master Profesional "Studime mbi Sigurine" ju ofrohet te diplomuarve te arsimit te larte (Diplome e niveli I+II, Diplome e sistemit te vjeter 4 vjecar) te interesuar per pervetesimin e programit Master Profesional ne fushen e sigurise kombetare dhe nderkomebtare. Studentet qe diplomohen ne kete program studimi perfitojne 90 kredite ECTS. |
| **Kriteri 2** Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi; | Kriteri 2. Pranimi i studenteve ne kete program eshte kryer ne perputje me Ligjin per Arsimin e Larte ne RSH nr 9741 dt.22.05 .2007 i ndryshuar, dhe akteve nenligjore ne fuqi. |
| **Kriteri 3** Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni; | Kriteri 3. Studentet qe frekuentuan masterin Studime mbi sigurine iu nenshtruan kritereve te pranimit dhe nga shqyrtimim i dokumentacionit ne sekretarine mesimore nuk konstatuam parregullsi. |
| **Kriteri 4** Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve "Master Profesional" niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve "Master i Shkencave" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve; | Kriteri 4. Studentet e programit Master Profesional "Studime mbi Sigurine" para marjes se diplomes jane te detyruar te japin provimin e gjuhes angleze mbi bazen e testeve te njohura nderkombtarisht. Me vendimin e Senatit Akademik te ""AU, nr. 303/2 dt 12.10 2o12 niveli I gjuhes angleze per programin master profesional eshte percaktuar A1. |
| **Kriteri 5** Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kritereve të pranimit. | Kriteri 5. Ne insitucion ka nje praktike per vleresimin e herepashershemte politikave te pranimit, per ndryshimin e permiresimin e kritereve te pranimit qe sherbejne per permiresimin cilesor te kontigjenteve te studenteve dhe te cilesis se pergatitjes se tyre. Por per programin Master Profesional "Studime per Sigurine", per mungese kontigjenti te studenteve dhe nderprejes se tij pas promocionit te pare 2011-2012 nuk konstatuam nj praktike te tille. |
| **Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të** | |

| programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit. | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve; | Kriteri 1 Studenteve ndjekes te programit Master profesional ne "Studime mbi Sigurine" iu jepet informacion per mundesine e punesimit dhe rritjes ne karriere te tyre ne institucionet dhe sektoret e sigurise kombetare si M. Mbrojtes, M. Brendshme, M. Jashtme SHISH, SHIU, M.Drejtesise etj |
| **Kriteri 2** Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion; | Kriteri 2. Studenteve iu jepet informacion per akreditimin e institucionit dhe te programit studimor respektive.<br>Ata kane qene ne kontakt me Departamentin per te patur dijeni mbi procesin e akreditimt te ketij programi dhe kane qene bashkepunues me grupin e vlersimit te jashtem per te dhene informacionin e kerkuar mbi cilesine e nivelin e ketij masteri. |
| **Kriteri 3** Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës. | Kriteri 3. Ne universitet funksionon zyra e keshillimit te karrieres, e cila mban kontakte mes studenteve dhe stafit akademik e administrative dhe zyrave te personelit ne sektorin publik e privat per nje informim te perhershem me kerkesat per vende pune. |
| **Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar; | Kriteri 1. Ne institucion konstatuam se ka nje baze te dhenash per studentet qe jane diplomuar ne programet e studimeve master profesional. Keto statistika ne u vune ne dispozicion ne zyren e kryesekretarise Per studentet qe jane larguar para perfundimit te programit. Per rastin programit master profesional "Studime mbi Sigurine" te promocionit 2011-2012 u pranuan 15 studente nga te cilet, 8 u diplomuan brenda sezonit, 3 ne sezonin e vjeshtes, 1 i padiplomuar dhe 1 u terhoq dhe 2 te fundit ne stash. |
| **Kriteri 2** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik; | Kriteri 2. Institucioni disponon sic konstatuam ne sekretarine mesimore statistika vjetore per studentet e rregjistruar ne programet studimore te ciklit te dyte, ata qe kane perfunduar studimet, qe jane larguar para perfundimit ose te mos perfundimit me sukses te programeve. |
| **Kriteri 3** Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim. | Kriteri 3. Institucioni disponon te dhena te plota per ecurine akademike te studenteve te programit master profesional qe nga pranimi e deri ne perfundim te masterit |
| **Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre; | Kriteri 1. Ne instititucion ka nje baze te dhenash per studentet e programit Master te punesuar pas perfundimit te programit. Pergjithesisht ata vazhdojne te angazhen ne po ato institucione por ne detyra te reja. |
| **Kriteri 2** Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj. | Kriteri 2. Nuk aplikohet ne rastin konkret |

| **Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.** | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit; | Kriteri 1. Studentet e programit kane marre informacionin e duhur per programin e studimit, afatet e perfundimit, organizimin e programit, stafin akademik, punimin e diplomes, akreditimin e programit etj. |
| **Kriteri 2** Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit; | Kriteri 2. Studentet jane informuar rregullisht e ne kohe per rezultatet e vleresimit ne lendet e programit dhe ne perfundim te tij. Kjo praktike pune ka ndikuar ne rritjen e shkalles se ndergjegjesimit per rritjen e rolit interaktiv te studenteve dhe pedagogeve ne procesin mesimor. |
| **Kriteri 3** Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve. | Kriteri 3. Pergjegjesi i modulit por edhe pedagoget e lendes kane diskutuar me studentet mbi rezultatet e ketyre vleresimeve, problematika te ndryshme rreth ecurise individuale te secilit student, kane shkembyer mendime dhe opinione mbi programin |
| **Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor; | Kriteri 1. Ne AU funksionon zyra e keshillimit dhe e karieres e cila ofron keshillim studenteve ne ceshtjet qe kane te bejne me procesin mesimor, te praktikave profesionale, vendeve te punes si ne sektorin publik ashtu dhe privat Institucioni AU bashkepunon ngushte me sektorin publik dhe ate privat per sigurimin e informacionit te perditesuar per kerkesat e tregut te punes per profesionet dhe profilet qe pergatit institucioni |
| **Kriteri 2** Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë. | Kriteri 2. Studentet e Masterit Profesional "Studime mbi Sigurine" kane zhvilluar praktikat profesionale para provimit te diplomes kryesisht ne institucionet ku jane te punesuar. |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Programi Master Profesional ne "Studime mbi Sigurine" i ofrohet te diplomuarve ne arsimin e larte te interesuar per kualifikimin e metejshem teoriko- praktik ne kete program cili jep 90 kredite ECTS.

Pranimi i studenteve ne program behet ne perputhje me kriteret e percaktuara ne ligjin per arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise nr,9741, dt 22.05 2007, dhe ne statutin e rreguloren e AU. Studentet e masterit profesional para dhenies se provimit te diplomes japing provoimin e gjuhes angleze mbi bazen testeve te njohuranderkombater te nivelit A1. Studenteve para rregjistrimit u jepet nje informacion i detajuar mbi programin, lendet mesimore, sistemin e krediteve e transferimit te tyre, mundesite e punesimit etj.

Zyra e keshillimit dhe Karieres jep nje ndihmese te mire per orientimin e dhe njohjen e studenteve me programet mesimore, rregulloret e funksionimit te Universitetit dhe te departamenteve, i ndihmon ata ne zgjidhjen e problemeve korente dhe u ben te ditur rezultatet ne vleresimin e tyre.

Institucioni disponon te dhena te sakta per studentet pjesemares ne programin master ne rregjistrin kryesor ne Sekretarine mesimore.

Dixhitalizimi i ketij rregjistri do tu mundesonte studenteve por edhe stafit akademik te informoheshin ne kohe te shkurter per ecurine e secilit student.

## KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

### 11. Kërkimi shkencor

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference**: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien

**Veprimtaria kerkimore shkencore e IAL** – Albanianm University organizohet dhe zhvillohet ne zbatim te Ligjit nr 9741 dt 21.05 2007 Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise, Veprimtaria kerkimore shkencore e ketij institucioni realizohet ne kuadrin e detyrave qe shtrohen ne planin strategjik te kerkimit shkencor qe harton institucioni duke marre ne konsiderate nevojoat dhe kerkesat ne perspektive te zhvillimit te Albanian University ,hapjen e fsakulteteve , departamente dhe programeve te reja studinore, permiresimit e cilesise se pergatitjes se studenteve ne tre nivelet e arimit te larte Bachelor Master profesional dhe doktorature, shtimin e botimeve shkencore, permiesimit te infrastruktures se kerkimit shkencor, perdorimit te metodave dhe teknologjive te reja ne mesimdhenie, rankimin e universitetit ne listen e universitete cilesore brenda dhe jashte vendit, etj

**Ne Albanian University funksionon nje strukture efektive e cila orienton politikat e zhvillimit dhe kerkimit shkencor e cila perbehet nga**: Zyra e Orientiomit dhe Koordinimit te Veprimtarise Studimore, dhe e kerkimit Shkencor, nga Qendrat kerkimore – shkencore prane Fakulteteve dhe berthamat e veprimtarise kekimore shkencore prane departamenteve

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

☑ Eksperti përshkruan gjëndien e konstatuar në Institucion në Raport me të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues. Eksperti evidenton ndryshimet dhe shprehet nëse ka ndyshime dhe sa këto ndryshime ndikojnë në përmbushjen e standardeve që lidhen me këta tregues.

Nuk ka ndryshime ndermjet te dhenave te paraqitura ne Raportin e Vlersimit te Brendshem me ato te konstatuara nga ana tone.

**Të dhëna për kërkimin shkencor ne rang Universiteti dhe fakulteti per 5 vitet e fundit**

Numuri i projekteve kerkimore ne Rang Universiteti /Fakulteti 150

Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL...............849

Numri i projekteve kërkimore të fituara....................................150

Numri i projekteve të zbatuara ................................................68

Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL................149

Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL.........6057

Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor.........................1480

Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor..................1145

Numri i Çmimeve Kombëtare.......................................................6

☑ Dokumentacioni përkatës i marrë gjatë vizitave

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| **Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.** | |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse; | Kriteri 1. Personeli akademik i departamentit dhe i programit master profesional boton materiale shkencore ne revisten Optima, organ i ketij Universiteti, merr pjese ne konferenca dhe seminare shkencore ne vend dhe jashte vendit. |
| **Kriteri 2** Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit. | Kriteri 2. Angazhimi vetiak i stafit akademik ne veprimtari shkencore si botime ,referate dhe kumtesa ne konferenca e seminare, kontribuon ne rritjen e nivelit profesional si pedagoge universitare .<br>Ne institucion na vune ne dispozicion te dhena per kerkimin shkencor (Aktivitete te planifikuara individuale dhe ne rang Universiteti /Fakulteti ne pese vitet e fundit Shih tab nr 21. te Raportit te GVB. |
| **Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.** | |
| **Kriteri 1** Personeli akademik që angazhohet në mësimëdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;<br>**Kriteri 2** Personeli akademik që angazhohet në mësimëdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri. | Kjo rubrike nuk i takon ketij Programi. |
| **Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor; | Kriteri 1. Nuk rezultuan te dhena per programe specifike per kualifikim e metejshem profesional te personelit akademik te programit.<br>Ata mund te inkuadrohen ne studimet e doktoratures te cilat kane filluar ne vitin akademik 2012-2013 prane ketij universiteti |
| **Kriteri 2** Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit. | Kriteri 2. Institucioni lejon ndjekjen e kualifikimeve jashte vendit te stafit akademik dhe atij mesimor shkencor. |
| **Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi; | Kriteri 1. Institucioni disponon nje baze te dhenash per te studimeve dhe botimeve shkencore te veprimtarive shkencore te stafit mesiomnor te programit Master Profesional |
| **Kriteri 2** Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi; | Kriteri2. Universiteti "AU" ka nje baze te dhenash per monografi tekste mesimore, artikuj shkencore , referate e kumtesa te mbajtura benda dhe jashte vendit nga stafi akademik universitar. Prane Universitetit punon nje shtypshshkronje moderne ku nje pjese e mire e pedagogeve botojne monografi e studime, tekste, permbledhje leksionesh. Universiteti prezanton njekohesisht organin e vet shkencor, revisten "OPTIMA" |
| **Kriteri 3** Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi. | Kriteri 3. Universiteti ka nje baze te dhenash per angazhimin e stafit akademik ne nje seri projektesh e studimesh kombetare dhe nderkombetare. |

**Konkluzionet e vlerësimit:**
Ne fushen e kerkimit shkencor, ne IAL- Albanian University ka perpjekje te vazhdueshme per rritjen e kontributeve te stafit akademik ne prodhimtarine kerkimore- shkencore, permes botimit te teksteve, monografive, artikujve shkencore, pjesemarjes ne konferenca, seminare brenda dhe jashte vendit, botimit te artikujve dhe studimeve ne revisten OPTIMA organ i ketij institucioni.
Por sic konstatohet, puna kerkimore shkencore i referohet vetem permiresimit te dokumetacionit universitar dhe pak kerkimit te mirefillte shkencor qe kerkon fonde monetare dhe investime me te medha. Kjo dukuri haset thuajse ne te gjitha institucionet e arsmit te larte ne vendin tone.

## 12. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference**: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Institucioni I Arsmit te Larte Jo Publik "Albanian University" realizon marredhenie te mira bashkepunimi me institucioine te arsmit te larte publik e jopublic brenda dhe jashte vendit duke shkembyer dokumentacion unversitar, organizuar veprimtari te perbashketa shkencore, duke rritur kontributet ne realizimi e programeve dhe projekteve ne nivel kombetar e rajonal, duke forcuar lidhjet me komunitetin e biznesit dhe tregun e punes.

**Institucioni "AU" ka** krijuar lidhje te qendrushme me komunitetin e biznesit dhe tregun e punes per te mundesuar shkembim informacioni mbi dinamiken e kerkesave dhe pergatitjen sa me adekuate te studenteve per tu integruar sa me shpejt ne sektoaret e ekonomise shendetesise, arsimit, sigurise

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

☑ Eksperti përshkruan gjëndien e konstatuar në Institucion në Raport me të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues. Eksperti evidenton ndryshimet dhe shprehet nëse ka ndyshime dhe sa këto ndryshime ndikojnë në përmbushjen e standardeve që lidhen me këta tregues

☑ Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

Institucioni Albanian University ka nenshkruar mareveshje bashkepunimi me Universitetin e Studimeve te Palermos dhe te Pizes ne Itali . me Universitetin Corvinius te Budapestit (Hungari ) me Universitetin e L Aquilas (Itali)

Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare....300.
Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj........................................1149
Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit.......208
Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL........................................................ 2588
Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor: .......... 44 laboratore te fakultetit te shkencave mjekesore ,Revista Optima Biblioteka Universitare, Biblioteka OnLine Questia, salle kompjuterash , salla leximi .
Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore jashtë vendit dhe prezantime ................................527

☑ Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:

- Institucionet qeveritare bashkepunuese : Ministria e Puneve te Jashtme, Arkivi i Shtetit Shqiptar Departamenti i Administrates Publike

- Organizatat Profesionale:Instituti i Historise, Instituti i Sociologjise

☑ Dokumentacioni përkatës i marrë nga vizita në institucion

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| **Standardi/Kriteret** | **Vlerësimi sipas standardeve** |
|---|---|
| **Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.** | |
| **Kriteri 1** Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve "Master Profesional", institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;<br><br>**Kriteri 2** Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve "Master i Shkencave" ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit. | Kriteri 1. Ne rastin e programit Master Profesional ne "Studime mbi Sigurine" , institucioni "AU" ka realizuar marredhenie bashkepunimi me institucionet ku ishin te punesuar studentet e programit, praktike e njohur edhe ne universitete te tjera te vendit.<br><br>Kriteri 2. Per kryrjen e praktikave mesimore ne kuadrin e e programit "Master mbi Sigurine" , institucioni AU ka vendosur marredhenie te ngushta bashkepunimi me institucionet ku punonin studentet.<br>Institucioni "AU" ka vendosur bashkepunim institucional me Ministrine e Puneve te Jashtme, Arkivin e Shtetit, Departamentin e Administrates Publike, Institutin e Historise me te cilat ka nenshkruar marreveshje bashkepunimi si dhe me nje numur organizatash te biznesit vendas shiko tab 21 te aneksit |
| **Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi. | Kriteri 1. Ne programin Master profesional Studime mbi Sigurine, pedagoget kane shkembyer informacione per ecurine e programi dhe te studenteve. Keto informacione jane shkembyer ne menyre periodike, te organizuara nga pergjegjesi i programit<br><br>Kriteri 2. Marredheniet mes stafit akademik te ketij programi kane qene korekte dhe eshte shkembyer pervoje per realizimim kualitativ te programit. |
| **Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;<br><br>**Kriteri 3** Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit; | Kriteri 1. Instutucioni ka vendosur marredhenie bashkepunimi me disa universitete dhe instituc ione te arsimit te larte, publik dhe jopublik ne Shqiperi, Itali Hungari etj me te cilet ka nenshkruar mareveshje bashkepunimi dypalesh per shkembim dokumentacioni, pervojash organizim aktivitetesh te perbashketa studimore dhe kerkimore.<br>Ne kuader te bashkepunimit ndekombetar jane realizuar nje numer kenaqshem aktivitetesh shkencore individuale dhe ne rang institucional sipas nje plani bashkepunimi ne pese vitet e fundit. Tab 22 e raportit te vleresimit te brendshem,<br><br>Kriteri 2. Institucioni "AU "ka marreveshje bashkepunimi me institucionet ne te cilat kryejne praktiken mesimore studentet e programit master Profesional ne "Studime mbi |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4** Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve. | Sigurine"<br><br>Kriteri 3. Nuk disponohen te dhena per kete kriter.<br><br>Kriteri 4. Njesia studimore e programit Master Profesional harton nje raport per praktikat mesimore te studenteve ku analizohen problemetikat qe kane dale.gjate zhvillimit te tyre. |
| **Konkluzionet e vlerësimit:**<br>Institucioni IAL –Albanian University ka vendosur nje bashkepunim te ngushte me insitucionet ku studentet e programit Master Profesional ne" Studime mbi Sigurine" kane kryer praktikat mesiomore duke neshkruar me to marreveshjet perkatese.<br>Gjithashtu ne kuadrin e marreveshjeve qe ka nenshkruar ky institucion me homologet e tij ne Shqiperi, por edhe ne Itali (Universiteti i Palermos dhe Aquiles, Pizes) dhe ne Hungari (Corvinus)) jane parashikuar shkembime dokumentacioni e pervojash ne fushen e studimit e kerkimit shkencor, organizimit te veprimtarive shkencore te perbashketa si simpoziume, konferenca seminare te cilat i kane sherbyer kualifikimit te metejshem te stafit akademik te programeve studimore. | |

## ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Institucioni i Arsimit te Larte "Albanian University" e zhvillon veprimtarine ne permbushje te objektivave dhe misionit te percaktura ne Statutin dhe Rregulloren organike, mbeshtetur ne Ligjin per Arsmin e larte ne Republiken e Shqiperise nr.9741 te dt 21.05 2007, i ndryshuar dhe ne aktet nenligjore, te udhezimeve te Ministrise se Arsimit dhe Sportit.

"Albanian University" ka per mision kryesor te kontriboje ne progresin ekonomik e shoqeror te vendit, duke pergatitur speciliste te zot per sektoret e ekonomise, drejtesise, arsimit, marredhenieve nderkombetere, sigurise, mjeksise inxhinerise, te afte per tu pershtatur sa me me mire kerkesave ne rritje per mobilitet dhe dinamike te larte ne fushat prodhimit dhe te kerkimit.

Universiteti AU ka percaktuar "Strategjine e zhvillimit institucional per vitet 2013-2016" ne fushen e mesimdhenies dhe kerkimit shkencor, ka vendosur marredhenie te ngushta bashkepunimi me institucione omologe brenda dhe jashte vendit, me institucione shteterore dhe studimore, me boten e biznesi dhe tregun e punes.

Universiteti "AU" eshte organizuar ne baze te nje strukture te kompletuar dhe funksionale te perbere nga organet drejtuese qendrore dhe horizontale, njesite funksionale (fakultetet departamentet, programet studimore,) sherbimet dhe administrate, logjistika etj. Te gjitha njesite perberese punojne ne baze te Statuti dhe te Rregulloreve, ne zbatim te ligjeve ne fuqi per Arsimin e larte ne RSH

Programi i Studimit Master Profesional ne "Studime mbi Sigurine" eshte organizuar ne Fakultetin e Shkencave Shoqerore, ne departamentin e shkencave politiko –administrative, dhe ka funksionuar ne vitin akademik 2011-2012 si Master Profesional i ri

Masteri synonte tu jepte studenteve informacion te perditesuar per fushen e sigurise, ti aftesonte ata ne pervetesomin e koncepteve dhe praktikave bashkohore ne lemin e sigurise kombetare dhe nderkombetare per perballjen me sfidat dhe reziqet e kohes, kriomin e organizuar, terrorizmin, koripsionin, trafiqet etj

Programi Master Profesional "Studime mbi Sigurine" eshte zhvilluar per nje periudhe kohore 1 vit e gjysem te ndare ne tre semestra dhe studenti ne perfundim te studimeve merrte 90 kredite ECTS.

Ne kete program u regjistruan 15 studente, nga te cilet 11 jane diplomuar, 2 jane ne stazh pune dhe je eshte ç'rregjistruar. Stafi akademik i programit studimor perbehej nga pedagoge te kualifikuar dhe specialiste te fushes se sigurise, me tituj dhe grada shkencore Prof. As. Dr Doktor i Shkencave ose ne proces doktorimi

**A. Pika të forta**

1. Programi Master Profesional "Studime mbi Sigurine" u zhvillua ne perputhje me objektivat dhe qellimet e Institucionit "AU" i inkuadruar ne Strategjine e Zhvillimit istitucional per vitet 2013 - 2017. Ishte pjese e 5 programeve Master Profesional qe ofronte Fakulteti i Shkencave Shoqerore, departamenti i shkencave politiko administrative
2. Ne elaborimin e ketij programi dhe aplikimin e tij morri pjese nje grup pedagoges dhe ekspertesh me pregatitje te larte teorike praktike ne fushen e marredhenieve nderkombetare e te sigurise, te endit dhe te sherbimeve inteligjences.
3. Ne kete program u rregjistruan specialiste te fushes te sigurise kombetare te punesuar ne dikasteret e rendit publik, sherbimeve inteligjente, e pedagoge mesimdhenes ne arsimin e larte dhe institutet studimore.
4. Ne procesin mesimor stafi akademik i programit ka bere perpjekeje te vazhdueshme per te rritur nivelin cilesor te mesimdhenies nepermjet perditesimit te informacionit lendor perdorimit te metodave aktive dhe nxitjes se puneve te pavarura, rekomandimit per studentet qe te plotesojne dijet me nje bibliografi te pasur autoresh bashkekohore.
5. Ne kuadrin e realizimit te ketij programi njesia e sigurimit te brendshem te cilesise por edhe vete stafi akademik jane fokusuar ne ndjekjen ne proces te realizimit te tij duke perdorur instrumente dhe metoda te kontrollit dhe vlerersimit te vazhdueshem dhe periodik te studenteve.
6. Studentet qe frekuentuan me kohe te plote kete program u perzgjodhen mbi bazen e kritereve te percaktuara nga Statuti dhe Rregullorja e Universitetit, me note mesatare 7.5 dhe ishin pergjithesisht punonjes te organve te rendit dhe sigurise, te punesuar ne dikasteret qendrore si MB, MM, SHISH, SHIU etj. Ne perfundim te studimeve 11 prej tyre kane mare provimin e diplomes dhe vazhdojne te punojne ne institucionet e meparshme. Nota mesatare e studenteve qe kane dhene provimin e diplomes eshte 9
7. Universiteti zoteron nje infrastrukture te pershtashme per zhvillimin e procesit mesimor sipas standarteve te kerkuara, me salla leksionesh e seminaresh, laboratore e biblioteke, zyrash admistrative dhe sherbimesh te pajisura me inventarin e nevojshem per nje proces bashkekohor te mesimit dhe formimit profesional;
8. Universititeti ka vendosur marredhenie te mira bashkepunimi me institucionet ku kryejne praktikat mesimore studentet e programit dhe shkemben informacion rreth ecurise se tyre.

**B. Pika të dobëta**

1. Programi master profesional pati nje kontigjent te kufizuar studentesh, duke krijuar nje mjedis te ngushte veprimi per stafin akademik dhe rritur kostot financiare per mbajtjen e tij.
2. Pedagoget efektive te programi (PAE) ishin dy, ndersa ata me kontrate shtate (PAK). Ky raport numerik duhet te permiresohej permes angazhimit te me shume pedagogeve PAE, me titujt e

grada me te larta shkencore, pavaresisht se nje pjese e tyre ishte perfshire ne sistemin e doktoratures.

3. Programi Master Profesional “”Studime mbi Sigurine” funksionoi vetem nje vit mesimor akademik, megjithate duhej te evitoheshin disa pika te dobta te tij si mungesa e nje laboratori apo kabineti special per ceshtje te sigurise te pajisur me teknike dhe teknologji te reja.

**C. Mundesite**

1. Programi mund te prezantohej me me efikasitet brenda sistemit te organeve te sigurise kombetare si dhe per te interesuarit e tjere, per te terhequr nje kontigjent me te madh studentesh, kur dihen nevojat e ketyre sektoreve per specialiste me kualifikim te larte
2. Para hapjes te ketij programi master profesional duhej te behej nje testim me i mire i nevojave te tregut te punes per specialiste te fushes se sigurise, ne menyre qe te sigurohej vazhdimesia e programit per disa cikle studimi.

**D. Pengesat:**

1. Kontigjenti relativisht i ulet i studenteve ne kete program masteri vjen si rezultat i faktit se ka ende nje kerkese te ulet per shkalle te larta te kualifikimit profesional ne sektoret e sigurise kombetare, pasi me sa duket ne sistemin e vleresimit dhe te ngritjes ne karriere te punonjesve te sektoreve respektive nuk aplikohen me rigorozitet kriteret e kualifikimit permanent e te programuar profesional.
2. Ne sistemin e Arsimit te larte, ne programet master profesional per ceshtje te sigurise ka ende informalitet i qe pengon garen dhe konkurencen e ndershme, sidomos per fusha te tilla ku kerkohet pergatitje e larte profesionale dhe ekspertize speciale si per stafin akademik ashtu dhe formimin e studenteve qe ndjekin keto programe.

Ne perfundim te ketij Draft- Raporti, per Vleresimin e Jashtem te Programit Master Profesional “Studime mbi Sigurine” ne permbushje te standarteve shteterore te cilesise per programet e ciklit te dyte te studimeve, Grupi i Vleresimit te Jashtem i ngritur nga A.P.A.A.L arin ne perfundimin se:
Programi Master Profesional “Studime mbi Sigurine qe ofron” “Albanian University” i ploteson kriteret e cilesise.

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm**

Prof As. Dr Luan Hajdaraga

**ANEKSI 1**

***Tabela 1***: Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK)

| | PROGRAMI I STUDIMIT Master profesional ne "Studime mbi Sigurine" | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Numri i PAE | | Numri i PAK | | Në Total | |
| | Gj | Tituj/ Grada | Gj | Tituj/ Grada | Gj | Tituj/ Grada |
| Departamenti i Shkencave Politiko Administrative | 1<br>1 | MA<br>Dr | 3M<br>1M<br>1M | DR<br>Drnt<br>Prof as | 1<br>5<br>1 | Prof as<br>Dr.<br>Drnt<br>MA |

**ANEKSI 2**

Tabela 2: Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK)

| Fakulteti .I Shkencave Shoqerore, Departamenti i Shkencave Politiko Administrative | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër) | | Detyra në Dep. | Titulli /Grada | Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër) | | Titulli /Grada | Institucioni ku punon full time |
| 1 | Gjon Borici | Pedagog | MA | 1 | Zaho Golemi | Prof As. | Min Mbrojtjes |
| 2 | Alketa Marku | Pedagog | DRZ | 2 | Zihni Goxhaj | Dr | Min Mbrojtjes |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 3 | Irma Pashkja | Dr | Kuvendi |
| | | | | 4 | Irakli Kocollari | Dr | IALJ Luarasi |
| | | | | 5 | Mirela Rrumbullaku | Drnt | Min Mbrojtjes |
| | | | | 6 | Hasan Shkembi | Dr | Min. Brendshme |
| | | | | 7 | Mark Ndreca | Drnt | Disk |

**ANEKSI 3**

Tabela 3: Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatori/ët e programit të studimit

| Emër Mbiemër | Titulli/grada | Pozicioni në Këshillin shkencor |
|---|---|---|
| Alketa Marku | DR | Kordinator i programit |
| Dorjana Pan | Dr proc | Anetar |

**ANEKSI 4**

Tabela 4: Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

| Titulli | Dep 1 | | |
|---|---|---|---|
| | PAE | PAK | Raporti PAE/PAK |
| Profesorë | | | |
| Profesorë të As. | | 1 | |
| Doktorë | 1 | 5 | |
| Doktore ne proces | | 2 | |
| Pedagogë MA | 1 | | |
| Asistentë me Ma | | | |
| Asistentë pa Ma | | | |
| Personeli Administrativ | | | |

**ANEKSI 5**

Tabela 5: Të dhëna për anëtarët e NJSBC

| | Anëtarët e NJSBC | Detyra që ka në në NJSBC | Sa kohë ka në këtë detyrë |
|---|---|---|---|
| 1 | Elona Mehmeti | Drejtuese | 5 vite |
| 2<br>3 | Klotilda Dauti<br>Leudita Docaj | Anetare<br>Anetare | 1 vit<br>3 vit |

**ANEKSI 6**

Tabela 6: Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

| Lëndë/Module | Semes tri | ECTS | Orë mësimore | | | | | | | me |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Leksione | Seminare | Laborator | Praktikë | ru dit or | Pa va rur | Gji th sej | |

| | | | | ECTS | Në auditor | P. e Pavarur | ECTS | Në auditor | P. e Pavarur | ECTS | Në auditor | P. e Pavarur | ECTS | Në auditor | Punë e Pavarur | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Marredhenie Nderkombtare | 1 | **7** | **4** | 30 | 3 | **3** | 15 | 60 | | | | | | | 45 | 135 | **175** | 1 |
| 2 | Globalizim dhe Gjeopolitike | 1 | **6** | **4** | 30 | 70 | **2** | 15 | 15 | | | | | | | 45 | 105 | **150** | 1 |
| 3 | Forcat e armatosura dhe Shoqeria | 1 | **4** | **2** | 30 | 20 | **2** | 15 | 35 | | | | | | | 45 | 55 | **100** | 1 |
| 4 | Siguria Kombetare | 1 | **6** | **4** | 30 | 70 | **2** | 15 | 35 | | | | | | | 45 | 105 | **150** | 1 |
| 5 | Anglisht | 1 | **4** | **2** | 30 | 20 | **2** | 15 | 35 | | | | | | | 45 | 55 | **100** | 1 |
| 6 | Inteligjence dhe vendimarje | 1 | **7** | **4** | 30 | 70 | **3** | 15 | 60 | | | | | | | 45 | 130 | **175** | 1 |
| .. 7 | Organizata te sigurise Nderkombtare. | 2 | **4** | **2** | 30 | 20 | **2** | 15 | 35 | | | | | | | 45 | 55 | **100** | 1 |
| 8 . | Politika europiane e mbrojtjes dhe e sigurise. | 2 | **4** | **2** | **30** | **20** | **2** | **15** | **35** | | | | | | | **45** | **55** | **100** | **1** |

**ANEKSI 7**

Tabela 7: Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

| | Lënda /Moduli | Pedagogu/Pedagogët përgjegjës | Titulli/grada kualifikimi | Departamenti | Statusi PAE apo PAK |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Marredhenie Nderkombetare | Gjon Borici | MA | I brendshem | PAE |
| 2. | Globalizmi dhe Gjeopolitike poltike | Alketa Marku | DR | E brendshme | PAE |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 3 | Forcat e armatosura dhe Shoqeria | Zihni Goxhaj | DR | I Jashtem | PAK |
| 4. | Siguria Kombetare | Zaho Golemi | Prof i As.Dr | I Jashtem | PAK |
| 5 | Anglisht | Mira Pashkja | Dr | E Jashtme | PAK |
| 6 | Intiligjenca dhe vendimmarje | Irakli Kocollari | Dr | I Jashtem | PAK |
| 7 | Organizata te sigurise nderkombetare | Mirela Rumbullaku | Drnt | E Jashtme | PAK |
| 8 | Politika Europiane te Sigurise dhe Mbrojtjes | Alketa Marku | Dr | E brendshme | PAE |
| 9 | SociologjiPolitike.Sistemi Politik dhe Siguria Kombetare | Zihni Goxhaj | Dr | I jashtem | PAK |
| 10 | Komunikim Nderkombetar.Aksione Psikologjike Lufte Mediatike | Hasan Shkembi | Dr | I Jashtem | PAK |
| 11 | Poltike Jashtme dhe ceshtje te sigurise | Gjon Borici | MA | I brendshem | PAE |
| 12 | Roli i Policise ne ceshtje te sigurise | Hasan Shkembi | DR | I Jashtem | PAK |
| 13 | Ballkani dhe Ceshtje te sigurise | Mark Ndreca | DRnt | I Jashtem | PAK |